



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” i

Institucionit të Arsimit të Lartë

Universiteti “BARLETI”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.As. Edi Puka
2. Prof.As. Robert Çitozi

Qershor / 2022

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës



Programi i Ciklit të Dytë të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” ka startuar në vitin akademik 2018-2019 ndërsa nga viti akademik 2019-2020 dhe në vazhdim është pjesë e njësisë bazë: “Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve”.

Ky program është pjesë e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit në Universitetin “Barleti” dhe që në zanafillën e tij ka synuar në krijimin e një programi shumëdimensional ku teoria, praktika, kërkimi shkencor dhe praktikat mësimore të mësimdhënies të kishin një ndërthurje e korrelacion harmonik me synimin e një formimi sa më të plotë për një të nesërme e cila do të mundësonte punësim dhe kontribute si në fushën akademike ashtu edhe në mësimdhënie në arsimin parauniversitar.

Hartuesit e këtij programi kanë synuar të shmangin një problematikë e cila është konstatuar në vite, ku studentët që përfundonin ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave, nuk gëzonin të drejtën që të punësoheshin edhe si mësues në arsimin parauniversitar. Pikërisht ky handicap ligjor ka sjellë si nevojë imediate hartimin e një programi të tillë multidisiplinar i cili normalisht do të ndiqej nga studentët me rezultatet më të larta në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor.

Sigurimi i një stafi pedagogjik të kualifikuar me grada dhe tituj si dhe sigurimi i ambienteve mësimdhënëse të standarteve europiane ka mundësuar pretendimet për një program studimi i cili me filozofinë “studenti në qendër” do të sigurojë një diplomë kompetitive në tregun e punës në fushën e Edukimit Fizik dhe Sporteve në Shqipëri.

Filozofia dalluese arsimore e këtij programi është se ai promovon dhe zbaton kombinimin e studimit akademik me mësimin e aplikuar në botën profesionale duke mundësuar që kompetencat specifike të tij të lidhen me aftësimin për të aplikuar një qasje sistematike në kërkimin shkencor, hartimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e një strategjie për edukimin fizik dhe sportin në tërësi si dhe sugjerimin e zgjidhjeve në fushat e aktivitetit fizik për shëndet në veçanti.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të parë për programin e studimit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte" bëhet në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017".

Mbështetur në dokumentacionin që disponojmë, Universiteti "Barleti" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte", nëpërmjet shërbimit në AMS.

Aplikimi zyrtar i IAL-së është dorëzuar në ASCAL më datë 22.10.2021: (Shkresë e IAL Nr.1123 prot, datë 21.10.2021, dërgon formularin e aplikimit - regjistruar ne protokollin e ASCAL Nr. 283 prot, datë 22.10.2021).

ASCAL me dokumentin 283/1 Prot datë 16.12.2021 me lëndë: "Konfirmim i aplikimit për akreditimin e 11 programeve të studimit", konfirmon aplikimin dhe pagesën e detyrueshme në bankë për programin e studimit që po vlerësohet.

Gjithashtu me Urdhër Nr.19 datë 23.02.2022 të ASCAL "Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti "Barleti", janë përcaktuar si ekspertë për vlerësimin e jashtëm të këtij programi studimi: Prof.As. Robert Çitozi dhe Prof.As. Edi Puka. Koordinator teknik nga ASCAL në këtë vlerësim është Msc. Arjana Alija.

Nëpërmjet specialistëve të ASCAL ne si GVJ, jemi informuar në kohën e duhur mbi agjendën e fazës së vlerësimit për programin e studimit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte" (Universiteti "Barleti"). Gjithashtu në zyrat e ASCAL kemi zhvilluar trajnimin e duhur për procesin e vlerësimit të jashtëm të këtij programi studimi.

Kjo procedurë vlerësimi kulmoi me vizitën dyditore në institucion ku sipas agjendës arritëm të ballafaqonim dokumentet shkresore me realitetet konkrete me të cilat u përballëm. Jemi të bindur që ky proces vlerësimi ka respektuar maksimalisht kornizën ligjore të akreditimit të programeve të studimit në IAL-të shqiptare.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte". Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 14.06.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.20/46 prot, datë 14.06.2022 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 14.06.2022 dhe me shkresë zyrtare Nr.20/49 Prot, datë 20.06.2022.

Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" të ofruar nga Unevirsiteti "Barleti"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Barleti"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve (Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 505, datë 17.10.2016
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite/ 4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE/ 0 PAK v.a 2021-2022
18	Numri i studentëve:	35 studentë v.a 2020-2021 22 studentë v.a 2021-2022
19	Komente / të tjera:	

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE “MËSUESI NË EDUKIM FIZIK DHE SPORTE”

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.

Bazuar dhe mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, dalim në konkluzionin që ky program studimi i Ciklit të Dytë, Master Shkencor “Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte”, nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por është një vlerë e shtuar në tregun e punës si një ofertë akademike në përgatitjen e misionarëve të dijes jo vetëm në arsimin parauniversitar, por edhe në atë universitar. Programi ka miratimin e ministrisë përgjegjëse dhe ofertën e tij akademike e sjell në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit.

Ofrimi i programit të studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” ka synuar të shmangë një problematikë e cila është konstatuar në vite, ku studentët që përfundonin ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave, nuk gëzonin të drejtën që të punësoheshin edhe si mësues në arsimin parauniversitar. Pikërisht kjo ka sjellë si nevojë imediate hartimin e një programi të tillë multidisiplinar i cili normalisht që nga fillimi është ndjekur nga studentët me rezultatet më të larta në përfundim të ciklit të parë të studimeve Bachelor mbështetur mbi kërkesat gjithnjë e në rritje të një mësimsdhënie sa më cilësore në Shqipëri, për profesionistë dhe specialistë të kualifikuar për të shërbyer cilësisht në sektorin e edukimit.

Në Strategjinë e zhvillimit institucional 2020-2030 ku theksohet kredoja institucionale “Krenarë për të shkuarën dhe vizionarë për të ardhmen”, synohet shndërrimi i universitetit në një institucion me dimensione bashkëkohore dhe të krahasueshme me standartet europiane universitare ku në qendër të tij është studenti. Ky program synon të kontribuojë në përmirësimin e standardeve, cilësisë dhe rritjen e vlerës së edukimit fizik dhe sportit si një nga faktorët e rëndësishëm parandalues për krijimin e një shoqërie më të shëndetshme sot e në të ardhmen.

Ky standart përmbushet plotësisht.

Evidenca 2: Statuti UniBa, Tiranë, 2020.

Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.

Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti. 2021

<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti “Barleti” i liçencuar me VKM Nr. 571, datë 12.08.2005 dhe i akredituar me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021, ka synuar krijimin e një institucioni të arsimit të lartë cilësor, si një aktor zhvillimi i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie, si dhe të ofrojë mundësi studimi përgjatë gjithë jetës. Ky program studimi kombinon sfidën akademike me trajnimin dhe aftësitë duke i pajisur studentët me kompetencat e domosdoshme profesionale, për punësim në të ardhmen. Programi i studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” synon ndërtimin, ruajtjen, konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe një qasje zhvillimore të qëndrueshme dhe afatgjatë.</p> <p>Programi i studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” i hapur me Vendim të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë Nr.191 dt. 07.07.2016 është organizuar si program i ciklit të dytë master, në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë si dhe në kuadrin e Kornizës shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p> <p>Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga IAL-ja, UniBa ka për mission që të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe të së ardhmes si dhe qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. UniBa ka qëllim të ofrojë studime universitare të cikleve të ndryshme dhe në përputhje me kornizën europiane të kualifikimeve EQF dhe kornizën shqiptare të kualifikimeve KSHK, të lidhura ngushtë me praktikën dhe aplikimin për të përgatitur teknikë, specialist dhe ekspertë të mirëinformuar. Programi i studimit synon një ofertë akademike të pasur dhe gjithëpërfshirëse duke krijuar një përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar, shërbime me vështrim ndaj biznesit dhe sipërmarrjes. Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” synon paisjen e studentëve me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për të përdorur në karrierën profesionale në sektorin e sportit si dhe aftësimin për të përballuar kërkesat e tregut të punës në fushat dhe sektorin përkatës. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 2: Statuti i Universitetit Barleti</p> <p>Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p> <p>Evidenca 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit</p>


<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programi i studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi Edukim Fizik dhe Sporte” synon pajisjen e studentëve me kompetencat e nevojshme për të qenë të aftë të përballojnë kërkesat e tregut të punës në sektorin përkatës. Programi synon plotësimin e nevojave në rritje në vend për mësues të kualifikuar në fushën e edukimit fizik dhe sporteve si dhe nevojat për stafe akademike të kualifikuar jo vetëm në UniBa, por dhe në IAL-të me programe studimi të njëjta apo të ngjashme. Rritja e orëve mësimore javore në shkollat e arsimit parauniversitar, shtimi i qëndrave të fitnesit si dhe turizmit sportiv dhe të aventurës janë mundësi të mëdha punësimi dhe zhvillimi ekonomik lokal apo kombëtar.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p> <p>Evidenca 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Referuar Ligjit 80/2015, programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Ai krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë si dhe aftësimin e thelluar profesional dhe shkencor.</p> <p>Këto programe organizohen në: a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike. Pranimi në programet e ciklit të tretë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë fituar diplomën “Masteri shkencave” ose “Master i arteve” dhe plotësojnë kriteret e pranimit, të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve pjesë e UniBa mund të ofrojë në të ardhmen edhe programe të ciklit të tretë pasi të ketë përmbushur kriteret dhe procedurat ligjore në fuqi.</p> <p>Kjo do të mundësonte mbylljen e ciklit të plotë për studentët e këtij programi studimi që synojnë studimet doktorale, por do tu shërbente edhe një numri jo të vogël të stafit akademik me kohë të plotë të cilët prej vitesh vazhdojnë si MSc.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015.</p> <p>Evidenca 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423



Web site: www.ascal.al



E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>“Strategjinë dhe planin e zhvillimit strategjik të institucionit 2020-2030” miratuar nga Bordi i Administrimit në 16.02.2021, kur e ballafaqojmë me planin strategjik për zhvillimin e programit na bind se zbatimi i saj gjen mbështetje të plotë në programet e të gjitha cikleve që ofrohen, ku përmes shtyllës akademike synohet kryerja me efikasitet i procesit të mësimdhënies, me qëllim pajisjen e studentëve me dije bashkëkohore në fushën e mësimdhënies në edukim fizik dhe sporte nën udhëheqjen e një stafi akademik me grada dhe tituj përbërja e të cilit është përmirësuar nga viti në vit me prurje cilësore ku ndërthuret cilësia sportive me aftësitë e spikatura akademike. Ky standart përmbushet plotësisht. Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i UniBa përmban norma që rregullojnë veprimtarinë e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në garantim të autonomisë universitare dhe të lirisë akademike, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. I miratuar nga MASR me Urdhër nr. 360, dt. 23.12.2020 ai është dokumenti themeltar i funksionimit institucional dhe synon krijimin e një institucioni cilësor si një aktor e zhvillimit, i cili ofron vlera të vërteta profesionalizmi dhe qytetarie duke patur synime të qarta për të qenë një institucion inovativ dhe lider, i orientuar nga tregu i punës duke vendosur studentin në qendër. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatojmë që Rregullorja e Universitetit “Barleti” është një dokument themelor i veprimtarisë konkrete institucionale e cila rrjedh nga Statuti i institucionit është e hartuar në zbatim dhe në funksion të zbatimit të tij. Këto dy dokumenta themelore të normimit të aktivitetit insitucional gjykojmë që kanë shërbyer si bazë për hartimin dhe zbatimin e programit të studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” në përputhje të plotë me bazën rregullative të UniBa-s. Ky standart përmbushet plotësisht. Evidenca 2: Statuti i Universitetit Barleti 2020. Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2023. Evidenca 5: Rregullore Universitetit Barleti.</p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Në përputhje të plotë me Strategjinë e Universitetit “Barleti” dhe “Planin Strategjik të zhvillimit të programit të studimit”, janë ndërtuar emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. Institucioni gëzon kapacitet profesionale, ambientet, mjediset dhe gjithshka tjetër për realizimin me sukses të këtij programi. <u>Ka nevojë për përmirësimin e kurrikulës apo planit mësimor sepse ka disa mospërputhje në përqindjet e kategorisë së komponentit mësimor sidomos në semestrin e katërt ku detyrimet përmbyllëse arrijnë në 30 kredite apo 25% kur VKM-ja përkatëse lejon maksimumi 15%.</u> Organizimi dhe stuktura e programit të studimit Master i Shkencave</p>

	<p>në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, është ndërtuar për zhvillimin e programit në dy vite akademike, apo 4 semestra, por <u>shtrirja e punimit të diplomës gjatë të gjithë semestrit të katërt duhet rishikuar.</u></p> <p>Në përgjithësi përmbajtja e programit është hartuar për të ndërtuar kompetenca profesionale te studentët, në kuadër të formimit ndërdisiplinor të tyre në fushën e mësimdhënies në edukim fizik dhe sporte, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e dijeve bashkëkohore. Dokumentet e shqyrtura japin të dhëna në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi si edhe ndarjen e programit në profile. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstaton se ky master është i organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 4: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p> <p>Evidenc 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”.</p>								
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Referuar dokumenteve: Planit Strategjik 2020-2030 dhe Planit strategjik për zhvillimin e programit si edhe diskutimeve gjatë vizitës në Institucion me pedagogët e programit të studimit, GVJ vuri re se programi ishte konceptuar bazuar në një projekt të përbashkët kërkimi në fokus të të cilit ishin problematikat e shëndetit fizik dhe atij mendor, edukimi i brezave për një stilt ë shëndetshëm jetese me theksin që aktiviteti fizik dhe sporti janë profilaksia më efikase për një popullatë të shëndetshme si dhe për ulje të shpenzimeve në shëndetësi.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</p> <p>Evidenca 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="550 1288 710 1361">Niveli i përmbushjes</th> <th data-bbox="710 1288 933 1361">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="933 1288 1157 1361">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1157 1288 1380 1361">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” ka objektiva të qarta për paisjen e studentëve me njohuri bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e aftësive të veçanta në fushën e edukimit fizik, sportit, aktiviteteve rekreative, eventeve me synimin kryesor formimin e specialistëve të aftë për të punuar si mësues të edukimit fizik, por</p>

<p>profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>edhe në akademizëm.</p> <p>Ky program synon të promovojë aftësi trajnuese, analitike dhe kërkimore kompetenca të cilat mund tu japin të diplomuarve mundësinë e zbulimit dhe shfrytëzimit të informacionit dhe të rrisë kapacitetet e tyre krijuese dhe drejtuese.</p> <p>Studentët pajisen me dije, aftësi e kompetenca, të cilat shprehen përmes realizimit të objektivave që karakterizojnë profilin e programit dhe ato janë: - T'u ofrojë studentëve dije, njohuri dhe metodologji të thelluar kërkimore e zbatuese në fushën e edukimit fizik dhe sportit; - Të pajisë studentët me aftësi sa më të mira për përçimin sa më të saktë të njohurive të marra. - Të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësimin për kërkimin shkencor në këtë fushë. - Të zhvillojë aftësitë e menaxhimit për çeshtje të edukimit fizik dhe lëvizor.</p> <p>Ky program studimi tenton ti përgjigjet kërkesave të tregut të punës duke synuar cilësinë në një treg i cili po bëhet gjithnjë e më konkures.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 4: Plani strategjik për zhvillimin e programit</i></p> <p><i>Evidenca 7: Rregullorja e programit, Neni 3.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni e ka si detyrim që si përpara hapjes së programit të studimit ashtu dhe pas daljes së studentëve të kryejë studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron dhe kjo duhet bërë në mënyrë periodike. GVJ pasi shqyrtoni dokumentacionin e paraqitur nga IAL-ja del në konkluzionin se <u>Evidenca 16 dhe 17 nuk pasqyrojnë një studim të mirëfilltë të tregut të punës, por një opinion të përgjegjës të departamentit.</u></p> <p>Studimi i tregut konsiderohet mbledhja dhe analizimi i të dhënave që një institucion apo organizatë kryen për të përcaktuar pozicionin e tij/saj në krahasim me konkurrencën si dhe përcakton kërkesat e tregut të punës për produktin apo shërbimin që ofrohet.</p> <p>Një studim tregu përfshin: një analizë SWOT, mbledhjen e të dhënave për konkurrencën e saj si dhe sondazhet që krijojnë një tablo të qartë të kërkesës së produktit në tregun e punës i brendshëm apo ndërkombëtar.</p> <p>Sigurisht që departamenti ka të dhëna të marra nga burime të ndryshme si dhe nga vetë database të tij mbi punësimin e studentëve por dhe për kërkesat e tregut të punës. UniBa, Zyra e Alumnit dhe Karrierës sigurisht që mbledh të dhëna në mënyrë të vazhdueshme për punësimin e studentëve duke gjurmuar ecurinë e tyre në tregun e punës.</p> <p><u>GVJ gjykon që departamenti përgjegjës i këtij programi studimi do të mundësojë në vazhdim një studim të mirëfilltë tregu i cili është shumë i nevojshëm për një ecuri edhe më të suksesshme të këtij programi studimi.</u></p>

	<p><u>Ky standart përmbushet pjesërisht.</u></p> <p><i>Evidenca 16: Studimi i tregut të punës përpara hapjes së programit të studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”</i></p> <p><i>Evidenca 17: Studimi i tregut të punës pas daljes së studentëve në programin e studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”</i></p> <p><i>Evidenca 29: Të dhëna tabelore përmbledhëse për punësimin real të studentëve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i pajis të diplomuarit me njohuri të thella teorike si dhe aftësim për kërkim shkencor në fushën e edukimit fizik dhe sportit të mbështetur në metodat më bashkëkohore. Programi ka si objektiva mbështetur dhe në strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit: tu ofrojë studentëve dije, njohuri dhe metodologji të thelluar kërkimore e zbatuese në fushën e edukimit fizik dhe sportit, paisjen e studentëve me aftësi sa më të mira për përçimin sa më të saktë të njohurive të marra, ti pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi për kërkimin shkencor në këtë fushë si dhe të zhvillojë aftësinë e menaxhimit për çështje të edukimit fizik dhe lëvizor.</p> <p>Të diplomuarit në programin Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” kanë mundësi punësimi: në sektorin e arsimit dhe në mësimdhënie në ciklin fillor dhe para universitar, shkolla publike dhe private; si drejtues në ekipet e moshave shkollore; në institucione vendimmarrëse sportive; në administratën publike qendrore ose lokale ku hartohen politikët publike mbi sportet; në sektorë, institucione e qendra të shërbimeve rehabilituese për individë me nevoja e probleme të veçanta fizike dhe shëndetësore etj. Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 7: Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. Neni 2,3.</i></p> <p><i>Evidenca 38: Analiza e departamentit mbi arritjet e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe të aftësimin akademik e shkencor.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është i hartuar konform Kartës së Bolonjës, ato janë të organizuara në përputhje me Sistemin European të Transferimit të krediteve ECTS. Transferimi ndërmjet programeve kryhet në përputhje me rregullat e transferimit të krediteve si Brenda dhe jashtë vendit. Studentët mund të lëvizin në kuadrin e shkëmbimeve dhe projekteve ndërkombëtare. Kjo lëvizje rregullohet në bazë të rregullave të ekuivalentimit dhe mobilitetit.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” mbështetet dhe pasurohet me risitë në modelet e programeve të ofruara në IAL brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Kjo përputhje e tematikave të trajtuara lejon që të diplomuarit në</p>

	<p>këtë program të transferojnë lehtësisht studimet dhe në cikle të masterit shkencor brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit "Barleti" Neni 16.</i></p> <p><i>Evidenca 7: Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte". Neni 4,6,13.</i></p> <p><i>Evidenca 14: Plani mësimor i programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i Masterit të Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" në të gjitha komponentët e tij, në kuadër dhe të ndërkombëtarizimit dhe transferimit të krediteve është i hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacion dhe direktivat e BE-së. Për hartimin e planit mësimor të programit të studimit janë shqyrtuar, analizuar dhe konsultuar praktikatat më të mira të vendeve evropiane, por edhe praktikatat dhe eksperiencat më të mira në rajonin e Ballkanit, duke e ndërthurur me praktikën shumëvjeçare të stafit akademik për t'iu prezantuar studentëve një format modern e bashkëkohor i cili bën të mundur zhvillimin e kompetencave të duhura si për mësuesit e edukimit dhe shëndetit fizik ashtu edhe për ata që synojnë akademizmin.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 7: Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte".</i></p> <p><i>Evidenca 14: Plani mësimor i programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Konstatohet se Universiteti "Barleti" organizon çdo vit akademik praktika profesionale në institucione të ndryshme arsimore me studentët e këtij programi studimi. Praktika profesionale përbën një nga komponentët më të rëndësishëm të programeve të studimit të ciklit të dytë në këtë IAL. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në aspektin teorik, në një kontekst praktik profesional. Programi i studimit ka numrin e përcaktuar të krediteve për praktikën profesionale.</p> <p>23 kredite janë parashikuar për praktikën për orë të zhvilluara në institucion si dhe, orë për përgatitjen e raportit dhe materialet në funksion të kërkimit ose të dosjes profesionale. Udhëzime të detajuara jepen në "Paketën e Praktikës" dhe GVJ konkludon që praktika përputhet plotësisht me qëllimin dhe objektivat e programit dhe është në përputhje me direktivat ndërkombëtare për profesionet e rregulluara me ligj.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 7: Rregullore e Programit të Studimit Master Shkencor në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte".</i></p> <p><i>Evidenca-32. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit</p>	<p>Në programin Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik</p>

<p>“Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>dhe Sporte” nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet që lëndët / modulet ofrohen në gjuhën shqipe, në përputhje me urdhrin e licencimit të programit të studimit si dhe rregulloren akademike, por bazuar në syllabet e lëndëve/moduleve, vërejmë që bëhen përpjekje të kënaqëshme për kombinimin e literaturës shqipe me atë të huaj në mënyrë që studenti të aftësohet për përdorimin e 5 gjuhëve kryesore europiane sidomos kur ai bëhet pjesë e mobiliteteve psh. Erasmus. GVJ bazuar në cv-të e stafit akademik gjykon që institucioni dhe stafi i njësisë bazë ka kapacitetet e nevojshme, që të ofrojë për lëndë të caktuara të programit, mësim edhe në gjuhë të huaj, me qëllim nxitjen e shkëmbimit të studentëve me institucionet partnere perëndimore, pasi disa prej pedagogëve që japin mësim në këtë program studimi kanë përfunduar studimet e tyre të larta në universitetet perëndimore, të tjerë kanë përvojë në projekte me partnerë evropianë.</p> <p><u>Nisur nga kërkesat e kohës departamenti duhet të mendojë seriozisht që në kuadër të ndërkombëtarizimit apo të programeve të përbashkëta me institucione europiane si dhe të pritjes së studentëve të huaj në kuadër të mobiliteteve të garantojë ofrimin e programit edhe në gjuhën angleze.</u></p> <p><u>Ky standart përmbushet kryesisht.</u></p> <p>Evidenca 5: Rregullorja e UniBa-s. Evidenca 68.1 : Urdhëri i hapjes së programit. Nr.505, datë. 17.10.2016 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit .</p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Bazuar në evidencat e paraqitura GVJ konstaton se institucioni i përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar në gjuhën shqipe, në përputhje dhe me aktin e licensimit. <u>Në evidenca nuk na është paraqitur asnjë syllab i plotë në gjuhën angleze kur dihet prej disa vitesh që në programet e ciklit të dytë të studimit këto janë të nevojshme edhe sepse BA ka në përbërjen e tij edhe profesorë të huaj.</u></p> <p><u>Është kërkesë imediate që si fillim të gjitha syllabet e lëndëve/moduleve të përgatiten edhe në gjuhën angleze.</u></p> <p><u>Ky standart përmbushet pjesërisht.</u></p> <p>Evidenca 19. Plani mësimor dhe Syllabe MSH në EFS 20-21</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e</p>	<p>Me një eksperiencë rreth 17 vjeçare në fushën e arsimit të lartë dhe akademizmit, UniBa me dokumentacionin e paraqitur na dëshmon se në tërësinë e tij ai ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura</p>

<p>një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>në fushën akademike specifike për ofrimin e këtij programi studimi në atë fushë. Nga viti në vit pasqyrat dhe tabelat e paraqitura evidentojnë rritjen cilësore në grada e tituj të stafit akademik të brendshëm-me kohë të plotë dhe të jashtëm-me kohë të pjesshme. Ata janë emra të spikatur në fushën e shkencave sportive, biomjekësore dhe sociale dhe garantojnë realizimin e plotë dhe efikas të programit të studimit.</p> <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në total 8 staf akademik, prej të cilëve 3 me titullin Prof.Dr, 1 me titullin Prof.Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 0 Asistent Lektor.</p> <p>Kjo shkon në përputhje me rregullin që stafet akademike duhet të jenë në kualifikim një shkallë mbi programin e studimit ku japin mësim. Pra asnjë MSc apo asistent lektor nuk është i përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi.</p> <p>Titujt dhe gradat mundësojnë edhe udhëheqjet cilësore të diplomave në përmbyllje të vitit të dytë dhe të gjithë programit të studimit.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 24 – Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</i></p> <p><i>Evidenca 25 – Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” ofrohet në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve. Ky fakultet përmbledh fushat e studimit si: Psikologjia, Puna Sociale, Mësuesia, Turizimi, <i>Sportet dhe Edukimi Fizik</i>. Vetë emërtimi i Fakultetit është një sintezë e të gjitha fushave të përgjithshme të studimit në të cilat ofrohen programet specifike të studimit. Ky rakordim vërtetohet edhe në programet e ofruara nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit, ku përfshihen: Bachelor në “Edukim Fizik dhe Sporte”; Program profesional 2 vjeçar në: “Operator në fitness, palestër dhe organizim eventesh publike”; Master profesional “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”; MSH. “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Programi mësimor është i regjistruar si program i ciklit të dytë Master, Niveli 7 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe tenton të jetë i organizuar sipas veprimtarive formuese të klasifikuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave VKM nr. 41, dt. 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL” i ndryshuar” dhe përpiqet të jetë korrekt me direktivat dhe udhëzimet kombëtare e evropiane.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale Turizmit</i></p>

	<p><i>dhe Sporteve.</i> <i>Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit të EFS.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Studimet ndërdisiplinore, të quajtura edhe studime të përgjithshme të mëdha dhe që përmbajnë një numër kursesh apo modulesh të ndryshme dhe që lejojnë përshtatjen e diplomës dhe mundësojnë zgjedhjen e disa varianteve studimore në vazhdim nuk ofrohen nga institucioni për momentin.</p> <p>Në një të ardhme do të ishte mirë që njësia kryesore dhe ajo bazë të mendojnë seriozisht për studime ndërdisiplinore të cilët zgjerojnë mundësitë e varianteve të studimit për studentët.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale Turizmit dhe Sporteve.</i> <i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni del në konkluzionin se ndarja e detyrave dhe përgjegjësive në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e mirëpërcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të UniBa. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të ndara midis njësisë të ndryshme, por evidentohet qartë që pesha kryesore superohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>Në aktet rregullatore janë të përcaktuara qartë roli i drejtuesit të njësisë bazë, si dhe të koordinatorit të departamentit. Institucioni dhe drejtuesit e tij nxisin bashkëpunimin midis stafeve akademike dhe ndihmëse brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit,</p>

	<p>ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, duke siguruar mënyrën e duhur për të pasur marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi midis tyre.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale Turizmit dhe Sporteve.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Konstatohet që UniBa ka një numër të madh marrëveshesh me institucione homologe si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke ndjekur një politikë hapje institucionale për shkëmbime eksperiencash, programesh e stafesh akademike. Ai e ka përcaktuar këtë politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofron.</p> <p>UniBa ka një rrjet të konsiderueshëm marrëdhëniesh bashkëpunimi e partneritetesh nëpërmjet të cilëve organizon vizita studimore, praktikant profesionalë të studentëve, punë vullnetare në komunitet, etj.</p> <p>UniBa ka nënshkruar marrëveshje me IAL ndërkombëtare që janë: Šiauliai University, Lithuania; University of Valladolid; Universidad De Córdoba, Spain; Universidade Nova De Lisboa; University of South Bohemia, Czech Republic; University of Szczecin, Poland; Kodolanyi Janos University, Budapest, Hungary etj.</p> <p><u>Vetë Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me IAL të huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike.</u></p> <p><u>GVJ konstaton që për momentin nuk kemi marrëveshje të tilla aktive ndaj ato duhet të shikohen si prioritete në të ardhmen e afërt.</u></p> <p><u>Ky standart përmbushet kryesisht.</u></p> <p>Evidenca 32. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese për programin e studimit dhe për praktikën profesionale.</p> <p>Evidenca 33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar.</p> <p>Evidenca 35. Raport i fundit periodik analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit.</p> <p>-Marrëveshje Bashkëpunimi për program të përbashkët Universiteti Egerem Cabej.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me</p>	<p>GVJ konstaton se UniBa në funksion të realizimit të praktikave profesionale për studentët e Master i shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, ka marrëveshje të shumta bashkëpunimi me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Departamenti i Edukimit</p>

<p>institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Fizik dhe Sportit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shkolla, të ndryshme, me spitale, qendra rehabilitimi apo fitnesi etj. Në gjykimin tonë ky numër i konsiderueshëm marrëveshjesh me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit krijon kushtet dhe mundësitë që këto segmente shumë të rëndësishme të formimit profesional të realizohen me cilësinë e duhur.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 34: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) për praktikat profesionale.</p> <p>Kontrata Palestra Praktika.</p> <p>Kontratë me Teniss Tirana.</p> <p>Kontratë me Green Garden.</p> <p>Kontratë me Aquadrom 2018 (4 Vjeçare).</p> <p>Kontrate Salus vs Universiteti Marin Barleti.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me Palestren Praktika Tirane.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me QSUT tetor.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me Spitali Geraldina.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi me Spitali Universitar i Traumes.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur na jep një pasqyrë të qartë se institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ai ofron.</p> <p>Bazuar në modalitetet e përcaktuara në marrëveshjet e bashkëpunimit apo në marrëdhëniet me institucionet ku studentët kryejnë praktikën, procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara edhe nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i aktorëve dhe njëjësive të ndryshme të përfshira në këtë proces.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e programit të studimit.</p> <p>Evidenca 76. Format pakete praktike. Masteri Shkencave dhe Profesional në mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte. Korrik 2020.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>UniBa me eksperiencën e tij rreth 17 vjeçare në fushën e arsimit të lartë besojmë që ka përvoja të mobilitetit të stafit dhe të studentëve në përputhje me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta, por <u>përsa i përket departamentit i cili mbulon këtë program studimi nuk gjejmë dokumeta të cilat të vërtetojnë që institucioni ka bashkëpunime me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</u></p> <p>Kjo ashtu siç e kemi theksuar edhe në kriteret e mësipërme kërkon fillimin e marrëveshjeve dhe mobiliteteve për stafet akademike.</p>



	<p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p><i>Evidenca 17. B. Lista e Marrëveshjeve për mobilitetin e studentëve</i> <i>Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve.</i></p> <p><i>Evidenca 35. Raport i fundit periodik analitik i përfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit ne funksion te realizimit te programit.</i></p> <p><i>Evidenca 34.2: Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione jashtë vendit.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</p>	<p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve me qëllim mbarëvajtjen e procesit të arsimimit cilësor të programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” duke patur një numër të konsiderueshëm studentësh për mësuesi ka edhe një numër jo të vogël marrëveshjesh bashkëpunimi.</p> <p>Për të bërë të matshëm efikasitetin e këtyre bashkëpunimeve konstatojmë nga dokumentacioni i paraqitur se njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 35. Raport i fundit periodik analitik i përfitimit nga marreveshjet e bashkepunimit ne funksion te realizimit te programit.</i></p> <p><i>Evidenca 38. Analizë e Departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.6	
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton nga dokumentacioni i paraqitur se në UniBa bëhen përpjekje për të publikuar rezultatet e kërkimit shkencor me anë të veprimtarive shkencore si forume, konferenca, ëorkshope si dhe publikohen arritjet dhe rezultatet e kërkimeve. Punimet më të mira të diplomave të studentëve të masterit shkencor do të përbënin një mundësi e mirë për të publikuar rezultatet kërkimore në një periodik apo revistë që duhet ti përkasë fakultetit dhe departamentit. Anëtarë të personelit akademik kërkimor që japin mësim në këtë program studimi kanë publikuar tekste mësimore universitare që janë bërë pjesë të kurrikulës së programeve dhe gjenden në Bibliotekën e UniBa-s.</p> <p><u>Në tabelat e punës shkencore referime, botime në vite nuk gjejmë të</u></p>

	<p>pasqyruar punën kërkimore shkencore të çdo stafi akademik me kohë të plotë pjesë e departamentit i cili mbulon këtë program studimi. <u>Ky standart përmbushet kryesisht.</u> <i>Evidenca 43. Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit.</i> <i>Evidenca 45. Lista e teksteve në Bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Proçesi i vlerësimit të performancës në Universitetin “Barleti” synon realizimin e vlerësimit për të gjithë personelin (akademik, kërkimor dhe administrativ) bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> <p>Zyra e menaxhimit të burimeve njerëzore, ka kompetencën për menaxhimin e proçesit të vlerësimit të performancës së stafit sipas një kalendarit dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës. Ajo bashkërendon punën me koordinatoren e vlerësimit semestral të performancës dhe ndjekjen në përditshmëri të performancës dhe ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p> <p>Komisioni i vlerësimit të performancës, shqyrton vetraportimet e personelit akademik si dhe raportet e njëjësive akademike dhe strukturave mbështetëse pjesë e grupit “Barleti” të angazhuara në proçeset e kërkimit të aplikuar. Mbështetur në evidencat e mbledhura komisioni nxjerr udhëzime që synojnë përmirësimin dhe nxitjen e veprimtarive kërkimore shkencore në UniBa.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 11a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.</i> <i>Evidenca 38. Analizë e Departamentit përgjegjës për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Konstatojmë që UniBa e mat dhe e monitoron cilësinë e kërkimit shkencor me anë të komiteteve /bordeve të aktiviteteve dhe botimeve shkencore, që vlerësojnë abstrakte, artikuj për revistat shkencore apo referime në konferenca apo kongrese kombëtare apo ndërkombëtare. UniBa ka si politikë të saj nxitjen e stafit akademik që të punojnë seriozisht në kërkimin shkencor kryesisht për studime të mirëfillta kërkimore që botohen në revista të njohura perëndimore. Botimet mbështeten dhe nga shtëpia botuese “Dudaj”, pjesë e grupit “Barleti” https://www.ceeol.com/search/journal-detail?id=1152.</p> <p>UniBa ndjek politikën e informimit dhe promovimit mbi veprimtaritë shkencore të personelit, për botimet e stafit, por dhe departamentet që çdo vit përpilojnë listat e veprimtarive dhe botimeve kërkimore.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 2: Statuti UniBa, Tiranë, 2020.</i> <i>Evidenca 3: Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2030.</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.</p>	<p>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit Barleti. 2021</p> <p>Kodin e Etikës së Universitetit “Barleti” synon krijimin e një fryme Brenda organizatës që nxjerr në pah vlerat e ndershmërisë, tolerancës, drejtësisë, përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë bazuar në parime të pranuar bashkërisht dhe përmirësimin e imazhit të UniBa.</p> <p>Aty pasqyrohen synimet e institucionit, praktikat e mira që duhet të ndjekë çdo anëtar i UniBa-s, qofshin këta anëtarë të personelit akademik, administrativ apo studentë, për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si edhe praktikat e mira në veprimtarinë kërkimore shkencore e botuese.</p> <p>Në Nenin 14 pika 6 “Shmangia e plagjiaturës” UniBa inkurajon dhe ndihmon anëtarët e tij të kryejnë kërkime duke respektuar etikën akademike, duke shmangur plagjiaturën si dhe të respektojnë kërkesat për mbrojtjen e pronësisë së autorëve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 59. Kodi i etikës</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit në Nenin 3 thuhet se: programi ka si objektiv të “Pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi për kërkimin shkencor në këtë fushë. Programi i studimit Master i Shkencave “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, ka në fokusin e tij si primar pajisjen e studentëve me aftësi për kërkim të avancuar e të pavarur shkencor.</p> <p><u>Mungon dokumentacioni që vërteton përfshirjen, stimulimin apo mbështetjen apo financimin e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor nga ana e studentëve apo kërkuesit e rinj. Departamenti nuk duhet të mjaftohet vetëm me punimet e diplomave, por të synojë që pedagogu të çojë studentin drejt kërkimeve të mirëfillta shkencore në laborator. Kjo sigurisht kërkon që institucioni të ketë më shumë vëmendje në krijimin e laboratoreve të mirëfillta për matjet në sport.</u></p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1

Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentacionit dhe pas sqarimeve në vizitën në institucion del në konkluzionin se programi i studimit Master i Shkencave në: “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, është i organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite por jo në module që formojnë lëndët, dhe bazuar në Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në manualin e hartimit të programeve të studimit përcakton orët për kredit dhe studim individual. Në planin mësimor të paraqitur ka një mospërputhje në totalin e kategorisë A+B e cila sipas udhëzimeve në fuqi duhet të jetë jo më pak se 60% ku faktike janë 66 kredite ose 55%.</p> <p>Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, por në rastin e Detyrimeve Përmbyllëse-E kreditet nuk janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Këto detyrime duhet të variojnë nga 10-15% por në fakt u është dhënë 25% apo 30 kredite të cilat janë barazuar me të gjithë semestrin e katërt i cili i është dedikuar vetëm punimit të tezës së diplomës.</p> <p>Në përfundim të studimeve të tyre studentët e këtij programi grumbullojnë 120 ECTS.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 13a. Manuali i hartimit të programeve të studimit.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</p> <p>Evidenca 14.2 Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 2020.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit në Nenin 2 thuhet se programi i pajis të diplomuarit me njohuri të thella teorike si dhe me aftësim për kërkim shkencor në fushën e edukimit fizik dhe sportit e të mbështetur në metoda bashkëkohore. Objektivi i programit synon përgatitjen e dyfishtë si mësues të edukimit fizik dhe sportit, por edhe si profesionistë të fushave që lidhen më edukimin lëvizor dhe motor të tyre.</p> <p>Tek Neni 15 i kësaj rregulloreje thuhet se lëndët me zgjedhje dhe profile të programit i garantojnë formimit një hapësirë më të madhe zbatimi duke rritur mundësitë për përshtatjen dhe integrimin në tregun e punës. Ato krijojnë hapësirë për një përshtatje me kërkesat e tregut të punës për kualifikimet e mëtejshme.</p>

	<p>Gjithashtu studentët kanë hapësira konkrete për tu angazhuar në aktivitete ekstrakurrikulare nga një rrjet i gjerë shërbimesh studentore që ofrohen për ta në Universitetin “Barleti”.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte. Neni 2, 15.</i></p> <p><i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i></p> <p><i>Evidenca 12. Rregullore e Funkcionimit te Zyrave ne Sherbim te Studenteve prane UNIBA.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Në objektivat e programit të studimit të paraqitura në rregulloren e programit të studimit në Nenin 3 thuhet se programi ka si objektivi: Tu ofrojë studentëve dije, njohuri dhe metodologji të thelluar kërkimore e zbatuese në fushën e edukimit fizik dhe sportit. Të pajisë studentët me aftësi sa më të mira për përçimin sa më të saktë të njohurive të marra. Nëpërmjet përmbajtjes së lëndëve, metodave të mësimdhënies, detyrave të kursit, praktikave profesionale të studentëve jashtë universitetit të cilat janë pjesë e planit mësimor synohet që t’u jepen studentëve njohuri të përparuara akademike dhe shprehë praktike në fushën përkatëse të studimit, si dhe koncepte të të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p> <p>Ky program studimi Master i Shkencave në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, u mundëson studentëve dije, njohuri dhe ekspertizë të mjaftueshme për një punë të thelluar kërkimore e aplikative.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte. Neni 3.</i></p> <p><i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në Planin Strategjik për zhvillimin e programit të studimit thuhet që ky program synon: pajisjen e studentëve me një formim akademik bazë e të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për të përdorur në karrierën profesionale në sektorin e sportit si dhe aftësimin për të përballuar kërkesat e tregut të punës të cilat jo rrallë herë të vendosin përballë zgjidhjeve të problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> <p>Programi në strukturën e vet lëndore, e pasqyruar kjo edhe në përmbajtjen e syllabeve ka të harmonizuar drejt orët teorike, praktike, kërkimin shkencor, metodologjinë e tij dhe praktikat profesionale gjë e cila u mundëson të diplomuarve siguri në përballimin e situatave komplekse e të komplikuara që i përball realiteti i përditshëm profesional.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p>

	<p><i>Evidenca 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit.</i></p> <p><i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i></p> <p><i>Evidenca 14.2 Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 2020.</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi është i dizenuar bazuar ne aktet ligjore në fuqi Ligji 80/2015 apo VKM 41 dhe e ndryshuar. Programi i studimit Master i shkencave në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, por ka nevojë që të rishikohen raportet e komponentëve mësimorë A, B, C, D dhe E që ato të përputhen plotësisht me elementet e programeve të studimit të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore aktuale në fuqi.</p> <p>Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, por <u>duhet rishikuar mësimdhënia në semestrin e katërt.</u> Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i Shkencave” në fushën e arsimimit të kryer.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), dhe tentojnë ti qëndrojnë korrekt peshës së përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Kategoria A duhet 5-10% është 6 kredite ose 5%</p> <p>Kategoria B duhet 50-60% është 60 kredite ose 50%</p> <p>Kategoria C duhet 12-20% është <u>12 kredite ose 10%</u></p> <p>Kategoria D duhet 10% është 12 kredite ose 10%</p> <p>Kategoria E duhet 10-15% është <u>30 kredite ose 25 %</u></p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p><u>Gjykojmë që orët në auditor për kredit janë të ulta dhe është i lartë numri i orëve për studim individual, ku ato përcaktohen që të jenë më shumë se gjysma e 25-sës, por jo 18 orë.</u></p> <p>Bazuar në eksperiencat e të gjitha institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare 1 kredit në orët në auditor varjojnë në një mesatare 10-12 orë për kredit gjë e cila do ti çonte orët në auditor për vit akademik</p>

	<p>nga 463 apo 470 që janë respektivisht në vitin e parë dhe të dytë në 600 apo 720 orë për vit akademik në auditor.</p> <p>Ngarkesa për një vit akademik është 60 kredite në vit, përkatësisht 30 ECTS për semestër.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</p> <p>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit, i ka të përcaktuara kreditet për punimin e diplomës, të cilat ndodhen në kategorinë E “Detyrime Përmbyllëse” dhe ato sipas VKM Nr. 185 Shtojca 1 duhet të përbëjnë 10-15% të 120 krediteve, <u>në fakt ato zënë 25%</u> sepse <u>detyrimet përmbyllëse në planin mësimor janë 30 kredite ECTS pra 1 semestër i plotë!!</u></p> <p>Sa kohë përcaktohet që programi ka 4 semestra mësim duhet të rishikohet ndryshimi i krediteve për punimin e diplomës nga 12-18 kredite dhe diferenca të jetë mësim në auditor.</p> <p>Departamenti disponon një manual për punimin e dokumentit “Paketa e punimit të diplomës”, ku përcaktohet saktë aktiviteti kërkimor dhe procedurat e zhvillimit të punimit shkencor për përmbylljen e ciklit të studimit master shkencor Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</p> <p>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave në mesuesi në edukim fizik dhe sport.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	


Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017”, Universiteti "Barleti" ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master i shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik dhe</p>


	<p>Sporte", nëpërmjet shërbimit në AMS. https://www.ascal.al/sq/akreditimi/procedurat-e-vleresimit-dhe-akreditimit Gjykojmë që Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Ky standart përmbushet plotësisht. Evidenca 13b. Udhëzim për shkrimin e RVB për akreditimin e programeve.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit zyrtar të paraqitur konkludojmë se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ai ka në përbërjen e tij 4 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional 2. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve 3. Departamenti i Turizmit, Mikëpritjes dhe Rekreacionit 4. Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe të Shëndetit <p>Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve. Në UniBa është parashikuar të ketë një koordinator për çdo departament i cili mbulon nevojat kryesore për koordinimin e programeve të studimit që ofron departamenti. Nga vizita në institucion evidentuam që departamenti e ka organizuar punën midis anëtarëve të departamentit për të koordinuar mbarëvajtjen e këtyre programeve, duke caktuar një pedagog përgjegjës për secilin program mbështetur në kualifikimin e tij, i cili ka për detyrë të raportojë gjatë mbledhjeve mujore të departamentit për ecurinë dhe problematikat e programit të studimit dhe ecurinë e praktikave profesionale. Ky standart përmbushet plotësisht. Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Turizmit. Evidenca 36: Vendimi për emërimin e koordinorit të programit të studimit. Evidenca 6.b: Rregullore e Departamentit të Edukimit dhe Sporteve.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte", për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në total 8 staf akademik, prej të cilëve 3 me titullin Prof.Dr, 1 me titullin Prof.Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 0 Asistent Lektor. Kjo shkon në përputhje me rregullin që stafet akademike duhet të jenë në kualifikim një shkallë mbi programin e studimit ku japin mësim. Pra asnjë MSc apo asistent lektor nuk është i përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi. Titujt dhe gradat mundësojnë edhe udhëheqjet cilësore të diplomave në përmbyllje të vitit të dytë dhe të gjithë programit të studimit. Ky standart përmbushet plotësisht.</p>

	<p>Evidenca 23. Të dhëna tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe Njësinë përgjegjëse për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Gjykojmë që Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Numri i stafit akademik me tituj dhe grada, ku secili prej tyre është një personalitet në fushën apo lëndën që mbulon garanton një strukturë efikase konform përcaktimeve të Ligjit 80/2015 dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>DEFS përgjegjëse për programin e studimit në shqyrtim përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Ai ka në përbërje 24 anëtarë, 12 me kohë të plotë: 1 Prof.; 2 Dr; 9 MSc; dhe 12 me kohë të pjesshme: 1 Prof.As, 1 Dr, 10 MSc.</p> <p>Në këtë program studimi gjatë vitit akademik 2021-2022 nuk ka të angazhuar staf akademik me kohë të pjesshme gjë e cila mundëson që 100% e këtij programi studimi të realizohet me staf akademik me kohë të plotë.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 24. Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</p> <p>Evidenca 25. Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Neni 11 thuhet se: Veprimtari mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike ku përfshihen leksionet, seminarët, detyrat e kursit, prezantimet, projektet e kërkimit, pjesmarrjet në veprimtari të tjera shkencore, praktika etj.</p> <p>Në Nenin 12 thuhet se: Studenti është i detyruar të ndjekë praktikat mësimore të parashikuara në planin mësimor. Praktikrat zhvillohen në institucione, firma, organizata nën drejtimin e një pedagogu të caktuar nga departamenti.</p> <p>Konstatojmë se në këtë program studimi ka personel akademik të angazhuar seriozisht në realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 76. Format pakete praktike. Masteri Shkencave dhe Profesional në Mësuesi e Edukim Fizik dhe Sporte. Korrik 2020.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në</p>	<p>Konstatojmë se departamenti ka në strukturën e tij organike koordinatorin e departamentit. Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit ofron 4 programe studimi, 2 programe Master (Master Profesional dhe Master Shkencor në Edukim Fizik dhe Sporte) 1 program Bachelor (Edukim Fizik dhe Sporte) dhe 1 program profesional 2 vjeçar (Operator në fitness, palestër dhe organizime eventesh publike).</p>

përputhje me objektivat e tij.	<p>Në strukturën e UniBa-s është i parashikuar një koordinator për çdo departament i cili e koordinon punën e tij me pedagogun përgjegjës të programit të studimit. Nga vizita në institucion dhe bisedat me stafin pedagogjik të këtij programi studimi konstatohet që ka harmoni në ndarjen e zbatimit e detyrave, por koordinatori dhe pedagogu përgjegjës për praktikat profesionale duhet të raportojnë periodikisht në analizat e departamentit.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 36. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit EFS.</p>			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	<p>Universiteti “Barleti” ka të parashikuar një koordinator për çdo departament i cili e koordinon punën e tij me pedagogun përgjegjës të programit të studimit. Nga bisedat me stafin akademik të këtij programi studimi konstatohet që ka harmoni në ndarjen e zbatimit e detyrave dhe koordinatori e pedagogu përgjegjës për praktikat profesionale raportojnë periodikisht në analizat e departamentit.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 36. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit EFS.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.3	
Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Konstatohet se Universiteti “Barleti” veprimtarinë e tij akademike e ushtron i mbështetur në një gamë të madhe dokumentesh rregulluese, që janë të aksesueshme në sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit, në intranet. Çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ, pjesë e departamentit që mbulon programin e studimit, ka akses të plotë tek ky dokumentacion rregullues institucional, por edhe tek kurrikula e programeve të studimit, planet mësimore, syllabuset, rregulloret e programeve të studimit, si edhe aktet e brendshme rregullatore të IAL-së.</p> <p>Në fillimin e çdo viti të ri akademik, njësia bazë përcjell udhëzimet institucionale tek stafi akademik për përditësimin e dokumentacionit të programit të studimit, syllabet, cv-të, marrëveshjet e punës, planet e parashikimit të veprimtarisë kërkimore shkencore dhe ruan në version elektronik dhe të printuar dokumentacionin për çdo vit</p>





	<p>akademik.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 46. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së TIK.</p> <p>Evidenca 46.1 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit.</p> <p>Evidenca 47a. Të dhëna nga faqja zyrtare ëeb - Barleti online.</p> <p>Evidenca 48. Politikat institucionale të publikimit të informacionit. Digjitalizimi i UniBa, Platforma ËEB - Biblioteka online.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit në Nenin 11 thuhet se: Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike ku përfshihen, leksionet, seminarët, detyrat e kursit, prezantimet, projektet e kërkimit, pjesëmarrjet në veprimtari të tjera shkencore etj.</p> <p>Plani mësimor i këtij programi studimi në strukturën e tij na paraqitet me lëndë por <u>pa module që formësojnë lëndën</u> dhe tek ngarkesa totale në orë në planin mësimor <u>mungon pjesa laboratore</u> si element shumë i rëndësishëm për formimin e kërkuesve të rinj shkencor.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor ne Master i Shkencave ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</p> <p>Evidenca 14.2 Plan mesimor ne Master i Shkencave ne Mesuesi ne Edukim Fizik dhe Sporte 2020.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar sipas sistemit ECTS dhe sipas kategorive (A-E), dhe tentojnë ti qëndrojnë korrekt peshës së përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p>Gjykojmë që orët në auditor për kredit janë të ulta dhe është i lartë numri i orëve për studim individual, ku ato përcaktohen që të jenë më shumë se gjysma e 25-sës, por jo 18 orë. Bazuar në eksperiencat e të gjitha institucioneve kombëtare apo ndërkombëtare 1 kredit në orët në auditor variojnë në një mesatare 10-12 orë për kredit. Ngarkesa për një vit akademik është 60 kredite në vit, përkatësisht 30 ECTS për semestër.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</p> <p>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Evidenca 72. Memo 4, 18 dt. 25.08.2018 Per llogaritjen e krediteve</p>

	dhe shperndarjes se kohes mesimore ne SHLUJ UMB.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor ka informacionin e nevojshëm për ngarkesën mësimore semestrale dhe vjetore, orët në auditor dhe ato jashtë auditorit sipas VKM nr. 418, dt 10.05.2017. Institucioni ka një rregullore të përcaktuar qartë mbi frekuentimin, ndjekjen e programit mësimor, por dhe penalitetet nese kjo rregullore nuk respektohet nga ana e studentit. Gjithashtu institucioni dhe departamenti që është përgjegjës për këtë program studimi kanë një rregullore e metodologji të qartë mbi vlerësimin e dijeve si gjatë vitit ashtu edhe në provime.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor ne master i shkencave ne mesuesi ne edukim fizik dhe sporte 21-22.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në Statutin e Universitetit “Barleti” ka informacion të plotë me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve Neni 43, 60, 61. Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të institucionit UniBa dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 65. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.</p> <p>Evidenca 65a. Udhezim 54, dt. 09.01.2019 Per organizimi e procesit te rekrutim-regjistrimeve, 2019-2020.</p> <p>Evidenca 65b. Vendim Senati - Kriteret e pranimit të studentëve në 2020-2021.</p> <p>Evidenca 66. Rregullore per Transferimin dhe Regjistrimin ne Programet e dyta.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sport” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabet). Ato janë të strukturuar sipas formatit të miratuar në nivel institucioni por edhe respektojnë formatin e përcaktuar nga MAS, ku paraqitet informacioni i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë.</p> <p><u>Konstatohet që në jo pak syllabe ka nevojë për korrigjime sidomos në</u></p>

	<p>drejtim të mosvendosjes korrekte të literaturës apo faqeve që i korespondojnë temës në librin e rekomanduar.</p> <p>Duhet parë me vëmendje përcaktimi i literaturës së detyrueshme që do ishte mirë të ishin në kategorine leading books nga Human Kinetics duke ofruar prurjet më bashkëkohore tek studentët por edhe stafin akademik.</p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSh ne EFS 20-21</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht</p>	<p>Dokumentacioni i paraqitur nga IAL dhe i shqyrtuar nga GVJ-ja na krijon një tablo të qartë që përmbajtja e programit të studimit në UniBa është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë kryesisht në shqip dhe disa elemente të programit të studimit në anglisht.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit, parashikon që plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen apo përditësohen në mënyrë periodike. Syllabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit që prezantohet në lëndë të ndryshme.</p> <p>Sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në planin mësimor bëhen deri në masën 20% për programe të akredituara. Shpesh arsye për ndryshim bëhen daljet e VKM-ve apo udhëzimeve të reja nga institucionet që drejtojnë e normojnë punën në institucionet e arsimit të lartë. Alumni nxjerr shpesh në pah nevoja për përmirësim, ide të reja dhe propozime për ndryshime që përmirësojnë programet mësimore në përputhje me dinamikat apo nevojat e tregut të punës i cili kalon mes procesesh të vazhdueshme evolutive. Dosja e plotë është e arkivuar në shqip por jo në anglisht. Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 13a: Manuali i hartimit të programeve të studimit dhe ndryshimit të programeve ekzistuese.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>




<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Në Nenin 75 të Ligjit 80/2015 “Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve” thuhet: 1. Cikli i dytë i studimeve përfshin programet e studimit “Master i shkencave”, “Master i arteve” dhe “Master profesional”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. 3. Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në: a) programe që realizohen me jo më pak se 120 kredite formimi në vijim të ciklit të parë dhe me kohëzgjatje normale dy vite akademike. 5. Studimet e ciklit të dytë “Master i shkencave” përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Master i shkencave” në fushën e arsimit të kryer. Çdo semestër ka 15 javë dhe 3-4 javë janë për provimet dhe detyrimin përmbyllës.</p> <p>Në fillim të vitit akademik Rektori shpall organizimin e vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve. Ngarkesa mësimore javore në auditor është 15-16 orë mësimore në javë nga maksimumi 25 orë që lejohen në javë mësimore. <u>Ora zgjat 60 minuta nga 50 minuta që kërkojnë aktet ligjore në fuqi.</u></p> <p>Ky kriter plotësohet kryesisht.</p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</i></p> <p><i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave realizohet mbështetur në VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021. Kategoritë mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A, B, C D dhe E. Lëndët e ofruara janë ndërtuar me qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive të studentëve dhe rritjen e aftësive të tyre për t’u punësuar jo vetëm si mësues të edukimit fizik dhe sporteve por dhe për të ndjekur studimet e ciklit të tretë pas përfundimit të studimeve për të gjithë ata student që synojnë drejt akademizimit. Konstatojmë që emërtimi i programit është në përputhje me fushën e studimit që mbulon programi.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i></p> <p><i>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit</p>	<p>Lëndët që përfshihen në kurrikulën e këtij programi janë të organizuara sipas kategorive (A-E), të përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” dhe VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p>

<p>dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Konkretisht rezultojn se: Kategoria A duhet 5-10% është 6 kredite ose 5% Kategoria B duhet 50-60% është 60 kredite ose 50% Kategoria C duhet 12-20% është <u>12 kredite ose 10%</u> Kategoria D duhet 10% është 12 kredite ose 10% Kategoria E duhet 10-15% është <u>30 kredite ose 25 %</u> GVJ rithekson që për të mundur arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor që në ndryshimet e para 20% që mund të bëhen pas akreditimit të programit të studimit të <u>riorganizohet shpërndarja e krediteve në vitin e dytë për tu ballancuar më drejt në mësimdhënie semestri i tretë me atë të katërt.</u> Ky kriter plotësohet kryesisht. <i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i> <i>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, sipas bisedave dhe konsultimeve me drejtuesit dhe stafin akademik të programit është organizuar dhe hartuar duke konsultuar e marrë në konsideratë programe të ngjashme ndërkombëtare si dhe përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS) dhe AEHESIS. Një kredit është i barazvlefshëm me 25 orë punë të studentit, ku përfshihet dhe koha e orëve individuale të studimit të cilat duhet të jenë më shumë se gjysma e tyre.. Ngarkesa vjetore e një studenti, që ndjek këtë program studimi është 60 kredite. Raporti i orëve mësimore në pjesën më të madhe të programit të studimit është 2 leksione me 1 seminar, për lëndët me 6 kredite dhe 3 leksione dhe 1 seminar për lëndët me 8 kredite. Ky raport gëzojmë që është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Ky standart përmbushet plotësisht. <i>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</i> <i>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në kredite siguron integritet të aspekteve teorike të informacionit që jep një modul dhe aplikimeve të mundshme praktike dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese. Statuti i Universitetit “Barleti” ka material të plotë mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve Neni 43, 60, 61. Proçeset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në</p>

	<p>dokumentat rregullatorë të institucionit UniBa dhe të programit të studimit, në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve ose të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre.</p> <p>Për realizimin e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së tij janë shfrytëzuar eksperiencat ndërkombëtare duke rritur kështu mundësinë e transferimit dhe mobilitetit të studentëve si dhe mundësi për punësim pas përfundimit të studimeve apo vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 14. Plani mësimor në Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte 21-22.</p> <p>Evidenca 57. VKM Nr. 185, dt. 25.3.2021.</p> <p>Evidenca 65. Manual - Rekrutim-Aplikim-Regjistrim-Transferim.</p> <p>Evidenca 66. Rregullore për Transferimin dhe Regjistrimin në Programet e dyta.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41, dhe 185 duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Gjatë shqyrtimit të syllabeve të programeve të lëndëve të programit të studimit konstatojmë se një pjesë e tyre janë të përditësuara dhe janë të bazuara në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Por, konstatojmë edhe disa problematika:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ka syllabe ku është vendosur literatura pa faqet për tematikë -Ka syllabe ku literatura është e vjetër -Ka syllabe ku 100% e literaturës është e huaj <p><u>Sugjerojmë që syllabet pas këtij akreditimi të përditësohen me synime të qarta për përmirësimin e tyre në të ardhmen në favor të një mësimdhënie më cilësore.</u></p> <p>Ky kriter plotësohet kryesisht.</p> <p>Evidenca 19. Plani mësimor dhe syllabe MSh në EFS 20-21</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit dhe dokumentacionin plotësues të tij konstatojmë që programi Master i Shkencave në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, është i përqëndruar në marrjen e njohurive të thelluara në profesionin e rregulluar me ligj të mësuesit të disiplinave e sportive fokusuar në mësimdhënie me fëmijët dhe adoleshentët.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit garanton edhe fitimin e njohurive</p>






	<p>dhe kompetencave për të realizuar kërkim shkencor në fushat e stërvitjes dhe pedagogjisë sportive.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSh ne EFS 20-21</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve të ciklit të tretë, doktoraturës. UniBa mundet të vazhdojë përpjekjet për hartimin dhe miratimin e programeve të doktoratës në përputhje me fushat e studimit që mbulon fakulteti dhe departamenti që mbulon këtë program studimi.</p> <p>Harmonizimi i drejtë i raporteve të lëndëve të shkencave sociale, biomjekësore dhe atyre profesionale sipas kriterëve të AEHESIS mundëson punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> <p>Ky standart përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullorja e programit.</p> <p>Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSh ne EFS 20-21</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Evidencat e prezantuara si dhe konsultimet e bëra gjatë vizitës në institucion na qartësojnë që departamenti realizon një herë në vit mbledhje me anëtarët e Bordit të Karrierës dhe merr në konsideratë mendimet, propozimet dhe konsultohet me ta, për përmirësimin e programit të studimit si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të tij.</p> <p>Po ashtu studimet e mirëfillta të tregut të punës do të ishin të domosdoshme për të patur një pasqyrë të qartë të ndryshimit të kërkesave në tregun aktiv të punës.</p> <p><u>GVJ sugjeron që departamenti të bëjë studime të vërteta të kërkesave të tregut të punës e mos të mbetet në opinione individuale siç rezulton në evidencat e paraqitura.</u></p> <p>Ky standart përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti. Neni 38, 39.</p> <p>Evidenca 16. Studim per tregun e punes perpara hapjes se programit.</p> <p>Evidenca 17. Studim per tregun e punes pas daljes se studenteve.</p>
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>Konstatojmë se programi i studimit në gjithë kompleksitetin e tij arrin të transmetojë njohuri të thelluara kërkimore, duke i mundësuar studentëve njohuri të avancuara për studim, kërkime shkencore, analiza dhe llogjikisht vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë të studimeve, doktoratë.</p> <p>Detyrimet përmbyllëse të programit, realizohen nëpërmjet punimit të tezës së diplomës që është një punë kërkimore e realizuar nga studenti nën udhëheqjen shkencore të një pedagogu që ka grada ose tituj. Detyrat e kursit projektet apo essetë, që studentët zhvillojnë gjatë studimeve, promovojnë kërkimin individual të studentëve bazuar në kriterë shkencore.</p>

	<p>GVJ sugjeron që fillimi i punimit të diplomës duhet të fillojë që në fund të muajit dhjetor për ti dhënë kohën e duhur studentit dhe pedagogut udhëheqës për një punë studimore të paktën 6 mujore.</p> <p><u>Ky standart përmbushet kryesisht.</u></p> <p><i>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</i></p> <p><i>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>UniBa disponon Manualin e Burimeve Njerëzore i cili synon të sigurojë një menaxhim aktiv të burimeve njerëzore duke hartuar dhe zbatuar procedura e rregullore, politika, programe dhe shërbime që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit.</p> <p>Vizioni i UniBa-së është bashkëpunimi me profesionistë duke ofruar shërbime, politika dhe sisteme të burimeve njerëzore innovative, të orientuara drejt rezultateve. Nga dosjet e personelit akademik dhe cv-të e tyre dalim në konkluzionin se: Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Stafit që mbulon programin është i gjithi me kohë të plotë dhe i përket kategorisë “profesor”, “lektor”, pra 2 Prof., 1 Prof.As., 5 Dr.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 11. Manuali i Menaxhimit te Burimeve Njerezore.</i></p> <p><i>Evidenca 44. Permbajtja e Dosjes personale të stafit.</i></p> <p><i>Evidenca 44.1 Formati i Dosjes personale të stafit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e</p>	<p>Pasqyrat dhe tabelat e paraqitura po ti analizojmë nga viti në vit evidentojnë rritjen cilësore në grada e tituj të stafit akademik të brendshëm-me kohë të plotë dhe të jashtëm-me kohë të pjesshme. Ata janë emra të spikatur në fushën e shkencave sportive, biomjekësore dhe sociale dhe garantojnë realizimin e plotë dhe efikas të programit të studimit.</p> <p>Në programin e studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar në</p>

<p>moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>total 8 staf akademik, prej të cilëve 3 me titullin Prof.Dr, 1 me titullin Prof.Asc, 4 Lektorë me gradën Dr./PhD dhe 0 Asistent Lektor.</p> <p>Kjo shkon në përputhje me rregullin që stafet akademike duhet të jenë në kualifikim një shkallë mbi programin e studimit ku japin mësim. Pra asnjë MSc apo asistent lektor nuk është i përfshirë në mësimdhënie në këtë program studimi. Titujt dhe gradat mundësojnë edhe udhëheqjet cilësore të diplomave në përmbyllje të vitit të dytë dhe të gjithë programit të studimit.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 24 – Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit.</p> <p>Evidenca 25 – Të dhëna tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore theksohet se kjo zyrë në fokusin e saj ka: Rekrutimin e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë në përputhje me politikat e organizatës dhe legjislacionit në fuqi. Çdo fillim semestri njësitë bazë akademike evidentojnë nevojat për rekrutim stafi.</p> <p>Përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertiza akademike dhe kërkimore të pedagogut si edhe përvojës në fushën e mësimdhënies pranë IAL-ve të njëjta apo të ngjashme vendase apo të huaja.</p> <p>Niveli i kualifikimit të personelit akademik që angazhohet në këtë program studimi synon gjithmonë të jetë në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 11. Manuali i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.</p> <p>Evidenca 20: Cv e stafit akademik të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Profili i programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, një nga komponentët kryesorë dhe nga më të rëndësishmit të saj ka kryerjen e praktikës profesionale pranë institucioneve arsimore. Periudhën e praktikës profesionale, studentët e UniBa, të këtij programi studimi nëse kanë interes mund të zhvillojnë idetë e tyre për të realizuar punimin e tezës së tyre të diplomës duke shfrytëzuar facilitetet e institucioneve arsimore apo të shëndetit publik.</p> <p>Departamenti vë në dispozicion personel akademik si për praktikën profesionale ashtu edhe për instruktimin dhe udhëheqjen e punimit të diplomës dhe studentët mund të përzgjedhin se me cilin prej pedagogëve dëshiron të zhvillojë punimin shkencor, duke harmonizuar idetë për punimin dhe fushën e ekspertizës së vet udhëheqësit.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit.</p>

	<i>Evidenca 76: Paketa e praktikës profesionale.</i> <i>Evidenca 78: Orientime për punimin diplomës.</i>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	GVJ ka konstatuar edhe në kriteret e mësipërme që në programin e studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në edukim fizik dhe sporte”, në planin mësimor nuk janë planifikuar orë laboratorike, por në nivel fakulteti dhe institucioni ka zyra përgjegjëse, që merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve. Gjykojmë që ky Master Shkencor duhet të ruajë një balancë me fokusin e mësuesisë sepse <u>pa laborator një master shkencor del nga misioni i tij themelor që është kërkimi shkencor me matje e protokolle konkrete si instrument bazë për përgatitjet për ciklin e tretë të studimeve dhe akademizmin si mundësi punësimi.</u> Kriteri përmbushet kryesisht. <i>Evidenca 5: Rregullorja e programit të studimit.</i> <i>Evidenca 78: Orientime për punimin diplomës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Në Rregulloren e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë në Nenin 2 thuhet se: Kjo rregullore përcakton mënyrat e vlerësimit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, kodi i cilësisë dhe standartet e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), me qëllim përmirësimin e programeve të studimit dhe krijimin e kulturës së cilësisë në institucion. Me fokus përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit, konsultohet përmes mbledhjeve dhe takimeve me Njësinë për Zhvillimin Kurrikular dhe Cilësinë mbi sugjerimet për përmirësimin e programit të studimit. Rëndësi të veçantë kanë edhe propozimet dhe orientimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të ngushtë të “Bordit të Karrierës” që përbëhet nga profesionistë dhe ekspertë të fushës së sportit dhe aktivistë e njohës të mirë të tregut të punës në vend, rajon dhe më gjërë. Kriteri përmbushet plotësisht.

<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Evidenca 8. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise.</p> <p>Si në Statutin e UniBa ashtu edhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-30. Në Nenin 4 të Statutit thuhet se: UniBa ka për mision që të përgatisë studentët si profesionistë novatorë, krijues e sipërmarrës të aftë për sfidat e së tashmes dhe së ardhmes, si qytetarë të angazhuar të një bote në ndryshim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Në Nenin 6 theksohet: Shtylla e studentit në qendër e fokusuar në veprimtaritë studentore dhe komunitare. NJZHKC organizon në fund të çdo semestri pyetësorin me studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. (Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise Neni 5). Organizon fokus grupe me studentët ku Departamenti zhvillon në mënyrë periodike takime me studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 2: Statuti i Universitetit “Barletit”.</p> <p>Evidenca 3: Strategjia e zhvillimit insstitucional 2020-2030.</p> <p>Evidenca 8. Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar prej GVJ-së konstatohet se Zyra e Alumnit në UniBa mban të dhëna të përditësuara për punësimin e të diplomuarve të vet dhe karrierës, ruan kontaktet e vazhdueshme me studentët alumni dhe angazhohet maksimalisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve Alumni. Çdo vit organizohet një takim me Alumni ndër vite, takime në të cilët ndahen eksperiencat, arritjet dhe sillen këndvështrime të ndryshme nga tregu i punës si dhe merren prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. UniBa mbështet studentët Alumni me programe të caktuara të edukimit në vazhdim si dhe informimin e vazhdueshëm për mundësi punësimi.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 33. Tabele permbledhese per trajnimet profesionale te metejshme per studentet e diplomuar.</p> <p>Evidenca 69. Raportim vjetor Alumni.</p>
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Në konsultim me drejtuesit dhe stafet akademike GVJ del në konkluzionin që institucioni është gjithmonë i hapur për të bashkëpunuar me institucionet partnere me qëllim përmbushjen e nevojave specifike për programe studimi apo kërkimi, por <u>për momentin departamenti drejtues i këtij programi studimi akoma nuk ka përditësuar, përshtatur dhe riorganizuar programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</u></p>

	Kriteri plotësohet kryesisht. <i>Evidenca 34. Marrveshjet e Praktikave Mesimore Master i Shkencave ne mesuesi ne edukim fizik dhe sporte.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Në rregulloren e programit të studimit, në Nenin 3 theksohet se programi ka këto objektiva:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tu ofrojë studentëve dije njohuri dhe metodologji të thelluar kërkimore e zbatuese në fushën e ef dhe sportit. - Të pajisë studentët me aftësi sa më të mira për përçimin sa më të saktë të njohurive të marra. - Të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi për kërkim shkencor në këtë fushë. etj <p>Pjesë e veprimtarive mësimore është edhe puna kërkimore, e cila është konceptuar në mbështetje të programit të studimit, si përgjatë zhvillimit të lëndëve nëpërmjet përgatitjes së detyrave të kursit, esseve, projekteve dhe përdorimit të literaturës, ashtu edhe në periudhën e punimit të diplomës.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht. <i>Evidenca 7: Rregullore e programit të studimit.</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	<p>GVJ konstaton se Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve dhe Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit qëndrojnë në krye të organizimit dhe koordinimit të veprimtarisë së mësimdhënies, veprimtarive kërkimore ose sportive, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik me moton studenti në qendër. Njësia kryesore dhe ajo bazë nxisin dhe inkurajojnë anëtarët e tyre të marrin pjesë në workshop-e, leksione të hapura apo projekte kërkimore me karakter aplikativ etj. Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 43. Te dhëna te plota të aktiviteteve per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te stafit akademik në 5 vitet e fundit.</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit theksohet se ky program synon të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për ti përdorur në karrierën profesionale. Kompetencat specifike të programit lidhen me aftësimin për të aplikuar një qasje sistematike në kërkimin, hartimin, planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e një strategjie për edukimin fizik dhe sportin.</p>

	<p>Konstatohet nga bisedat me studentët e këtij programi studimi se pedagogët i nxisin studentët që detyrën e kursit, ta realizojnë në terren duke kryer një ministudim, bazuar në kriteret strikte të kërkimit shkencor. Duke qenë se detyrimeve përmbyllëse në master shkencor kanë obligative përgatitjen e një punimi shkencor në fushën e edukimit fizik dhe sporteve, ideimi dhe formësimi i projektit studimor nis në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve dhe pedagogu udhëheqës motivon dhe nxit studentin të hulumtojë mbi tema të ndryshme që lidhen me interesat e tyre dhe të kërkojë mbi metodën më të përshtatshme për hulumtim.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit theksohet se: Mënyra e zhvillimit të procesit mësimor, procedurat e kontrollit të dijes, rekrutimi i stafit akademik, këshillimi i studentëve, shërbimi i bibliotekës dhe mbi të gjitha kërkimi shkencor kanë si qëllim realizimin e një eksperiencë akademike unike në vend që nuk përjashton asnjë element domethënës të universiteteve europiane dhe ato amerikane.</p> <p>Konstatohet se UniBa ka ngritur njësinë “BRIDGE” (Barleti Research and Innovation, Driving Growth and Entrepreneurship), që ka për qëllim të nxisë dhe të promovojë rëndësinë e kërkimit shkencor për Shqipërinë dhe Rajonin. Kjo njësi shërben si organizëm që bashkëpunon ngushtësisht me departamentet, Institutet, dhe organizatat jo-fitimprurëse të themeluara nga institucioni dhe mundëson ndjekjen dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programit.</p>
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit theksohet se: Studentët e rregjistruar në këtë program studimi nuk mund të jenë periferikë-rajonale! Ato do të mundën dhe do të dijnë të konkurojnë në tregun e punës jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë saj. Për këtë do të kërkohen burime të reja financimi dhe plane më të sofistikuar mbështetëse për laboratorë të kërkimit të aplikuar, biblioteka interactive e të personalizuara, investime thelbësore në infrastrukturën sportive etj.</p> <p>Për realizimin e aktiviteteve me karakter kërkimor njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. Në UniBa administrimi i të ardhurave nga aktivitetet apo projekteve kërkimore realizohet në nivel institucional. Administratori i UniBa-s drejton, ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor dhe veprimtarive financiare të institucionit dhe në të gjitha strukturat e varësisë së tij.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p>

	<i>Evidenca 4. Plani Strategjik per zhvillimin e programit.</i> <i>Evidenca 50. Te dhena nga plani i financimit te programit te studimit.</i> <i>Evidenca 50a. Burimet Financiare UniBa.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2020-30 theksohet se UniBa synon të bëhet një institucion inovativ dhe lider, dixhital, aplikativ dhe praktik, ndërveprues dhe komunitar, i orientuar nga tregu i punës dhe duke zhvilluar bashkëpunime rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Një nga shtyllat e veprimtarisë së tij, UniBa ia ka kushtuar punës kërkimore shkencore. Shtylla e Kërkimit të Aplikuar dhe Inovacionit, ka në fokus organizimin dhe bashkëpunimin e njëjësive të angazhuara në veprimtaritë kërkimore me karakter shkencor dhe të aplikuar, inovacionin dhe projektet në fusha të ndryshme. Në Strategjinë e zhvillimit të institucionit theksohet se kërkimi shkencor do të orientohet drejt aplikimeve në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit dhe më gjërë duke synuar zhvillimin e inovacioneve. Koordinatorin për Kërkim dhe Inovacion (KKI), nën drejtimin dhe orientimin e Zëvendës Rektorit për Kërkimin e Aplikuar dhe Inovacionin, krijon lidhjen ndërmjet Departamenteve dhe strukturave të kërkimit të aplikuar të Grupit Barleti dhe koordinon zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si hartimin e strategjive, raportet, monitorimi dhe analizat, procedura, vlerësime etj, dhe aktivitetet si Konferenca dhe Botime, Evente, Projekte dhe Programe, Partneritet Ndërkombëtar dhe Promovim.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Evidenca 3.Strategjia e zhvillimit të Institucionit.</i> <i>Evidenca 43. Te dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik i Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, ka lidhje dhe bashkëpunim efikas e të vazhdueshëm me institutet e grupit “Barleti” dhe vlen të theksohet se disa prej anëtarëve të këtij departamenti janë po ashtu pjesë e tyre, të cilët angazhohen në projekte kërkimore aplikative, konsulenca, etj. Kjo mundëson që personeli akademik të pasurojë eksperiencën e vet akademike, por dhe</p>

	<p>të ndihmojë studentët të përfshihen në këto projekte. Evidencat tregojnë përfshirje jo aktive këto 2 vite të pandemisë nga ana e studentëve. Besojmë se institucioni do ta superojë këtë kohë jo efektive në ditët e vitet në vazhdim duke e patur kërkimin shkencor një sfidë e cila do ti shoqërojë drejt proceseve të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit.</p> <p>Në UniBa funksionon Zyra e Ndërkombëtarizimit, me varësi të drejtë përdrejtë nga Rektori e cila në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit fokuson aktivitetin e saj në :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes universitetit dhe institucioneve të tjera akademike, kërkimore, donatore dhe administrative. - Koordinimin dhe pjesë marrjen në mobilitete ndërkombëtare për kërkuesit shkencorë, stafin akademik, administrative dhe studentët... <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 3.Strategjia e zhvillimit te Institucionit.</p> <p>Evidenca 4. Plani Strategjik per zhvillimin e programit.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti. Neni 16.</p>
--	--

<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe bisedat me drejtuesit e fakultetit, departamentit dhe stafin akademik dhe studentët konstatojmë që vetë departamenti ose fakulteti nuk kanë organizuar akoma një konferencë shkencore të tyren apo të kenë një revistë shkencore të fakultetit. Sigurisht që njësia përgjegjëse e programit organizon aktivitete të ndryshme që mundësojnë studentët të njihen me perspektiva të ndryshme të fushës së mësuesisë dhe sportit. Në UniBa janë një praktikë e zakonshme leksionet e hapura, ku të ftuar janë profesionistë të ndryshëm nga fusha që mbulon departamenti i edukimit fizik dhe sporteve ku pjesëmarrja e studentëve është mbresëlënëse.</p> <p><u>GVJ gjykon që fakulteti dhe departamenti janë në kohën e duhur dhe kanë të gjitha kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore për ta organizuar konferencën e parë shkencore me pjesëmarrjen qoftë edhe në nivelin poster të studentëve të këtij programi studimi.</u></p> <p>Ky kriter plotësohet kryesisht.</p> <p>Evidenca 43. Te dhëna te plota të aktiviteteve per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te stafit akademik në 5 vitet e fundit.</p>
--	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>GVJ konstaton se në UniBa është prioritet që studentëve tu ofrohen metoda bashkëkohore të mësimdhënies, zhvillimi i të cilave parashikohet në syllabusin e lëndës / modulit që rishikohen çdo fillim viti akademik për të qënë i përditësuar me të rejtat e fundit bashkë kohore.</p> <p>Gjithashtu UniBa ka hartuar një udhëzues për mësimdhënien dhe të nxënë. Ky udhëzues është një material që ndihmon në zhvillimin e formave pedagogjike të stafit akademik dhe në përmirësimin e procedurave të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> <p>Duke qenë se që nga Marsi 2020 u kalua për shkak të pandemisë në mësimdhënie on-line UniBa disponon një guidë instruktive për të kuptuarit, asimiluarit, mbështetjen dhe pasurimin e mësimdhënies on-line.</p> <p>Kjo guidë gjykojmë se i ka mundësuar stafit akademik të UniBa-s instrumenta, teknika dhe strategji të efektshme për mësimdhënien on-line, duke pasur në fokus dhënien e leksioneve, nxitjen e diskutimeve dhe reagimeve të studentëve për të nxënit e tyre, por dhe ka mundësuar zbatimin e teknikave efektive të vlerësimit, për nxitjen e të nxënit dhe matjen e rezultateve të studentëve.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 39a. Manual i mesimdhënies online.</p> <p>Evidenca 39b. GUIDE instruktive e mesimit On-line.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në UniBa funksionon Njësia e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë e cila funksionon në përputhje me Ligjin 80/2015, me Statutin dhe Rregulloren e institucionit. Në rregulloren e kësaj njësie përcaktohen mënyrat e vlerësimit të sigurimit të cilësisë në nivel institucional në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji 80/2015, Kodi i Cilësisë dhe Standartet e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL) me qëllim përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi kryhet duke zbatuar parimin e autonomisë institucionale.</p> <p>UniBa ka përcaktuar metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit në mënyrë periodike në lidhje me aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik. Vlerësimi</p>

	<p>përdoret për të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktuar nivelin e cilësisë së arritur - evidentuar praktikat positive - sjellë përmirësimë, ndryshime dhe zhvillime pozitive - të marrë vendime. <p>NJZHKC-ja ka si funksion:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin periodikisht të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. - Organizimin në fund të çdo semestri të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 8. Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Neni 2, 15.</p> <p>Evidenca 40. Pyetësor i studentëve për lëndën.</p> <p>Evidenca 41. Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Në Rregulloren e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë në Nenin 2 – Parimet e Vlerësimin në pikën h thuhet: Studentët janë pjesëmarrës në vlerësim. Ata marrin pjesë nëpërmjet plotësimin të pyetësorëve, ndërmjet pjesëmarrjes në intervista, fokus grupe dhe ekipe të vlerësimin. Formulaët sigurojnë anonimitetin dhe vlerësimin është një piketë për reflektim kritik.</p> <p>Të dhënat që dalin nga pyetësorët e vlerësimin të studentëve trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe janë object analize në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p>Vlerësimin periodik i formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimin të dijeve konsiston në dhënie e opinionit për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimin e lëndës - Përmbajtjen e lëndës - Materialet e lëndës - Komponentet e vlerësimin - Pedagogu. <p>Në Rregulloren e UniBa, Neni 37 thuhet: Dekani i Studentëve luan rolin e ombudsmanit të studentëve në mbrojtje të interesave të tyre dhe garantimin e një studimi cilësor.</p> <p>Në takimet me studentët e këtij programi studimi GVJ e konstatoi që studentët ndjehen të sigurtë, të dëgjuar dhe të mbështetur për çdo problem apo ankimim.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 8. Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Neni 2.</p> <p>Evidenca 40. Formular vlerësimin i studentëve për lëndën.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e</p>	<p>Në Nenin 5 të Rregullores së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë</p>

<p>cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>thuhet se :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kjo njësi në bashkëpunim me Zv.Rektorin Akademik ideon dhe organizon proceset e monitorimit të aktiviteteve mësimore. - Organizon në fund të çdo semestri pyetësin me studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi <p>NJZHKC harton raportin vjetor të të dhënave të mbledhura nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit parashiruar për funksionin e njësisë. Raporti vjetor i vlerësimit publikohet në faqen elektronike zyrtare të UniBa-s dhe bëhet publik për stafin dhe studentët edhe në sistemin e brendshëm të UniBa-s në INTRANET.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 8. Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë. Neni 5.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Në Rregulloren për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës në Nenin 1 - Qëllimi thuhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procesi i vlerësimit të performancës në UniBa synon realizimin e vlerësimit për të gjithë personelin (akademik, kërkimor dhe administrativ) si dhe strukturat përkatëse, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi. - Ky proces synon qartësimin e objektivave individuale të personelit në kuadër të atyre institucionale, verifikimin e realizimit të këtyre objektivave dhe analizimin e funksionimit të strukturave institucionale, vlerësimin e performancës së personelit dhe atij institucional. - Në raportin përfundimtar të procesit të vlerësimit synohet të paraqitet një tablo e qartë e të gjitha rezultateve të arritura dhe problematikave të evidentuara si dhe promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. <p>Të dhënat e mbledhura nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit diskutohen në mbledhjen e Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve për t'u njohur me modelet dhe praktikat e vlerësuara pozitivisht në mënyrë që të nxitën dhe motivohen shembujt më të mirë mes anëtarëve të departamentit.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 11a. Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës. Neni 1.</p> <p>Evidenca 40. Pyetësori i studentëve për lëndën.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, labororet, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj.</p> <p>Ndarja e tyre në program është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Leksione 374 (279 + 95) orë mësimore - Seminare 167 (125.4 + 41.8) orë mësimore - Orë mësimore sportive 57 (38 + 19) orë mësimore - Projekte/Detyra Kursi 28 (20.4 + 7.6) orë mësimore - Punë Laboratorike 0 (0 + 0) - Praktikë profesionale 203 (0 + 203) - Provë Finale 105 - Punë individuale e st. 2067 (1037 + 1030) orë mësimore <p>Programi lëndor (syllabus) i secilës lëndë miratohet nga Senati Akademik dhe nënshkruhet në fillim të çdo semestri nga pedagogu dhe Drejtuesi i Departamentit. Nga ana tjetër, plani i veprimtarisë së departamentit hartohet nga departamenti gjatë mbledhjeve të departamentit dhe i paraqitet Rektoratit të UniBa përmes Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit për miratim. Pas miratimit, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sportit ndjek realizimin e aktiviteteve.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit.</p> <p>Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit EFS. Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar</p>	<p>Për të bërë harmonizimin e mësimdhënies ku ka diversitet në nevojat e studentëve, stafi akademik mbështetet edhe nga pedagogët që shërbejnë si koordinatorë për çdo vit akademik si dhe nga struktura të tjera siç është Dekani i Studentëve dhe Zyra në Shërbim të Studentëve.</p> <p>Personeli akademik orientohet dhe nxitet nga departamenti në fillim të çdo semestri të kontaktojnë me studentët që të diskutojnë me stafin akademik, disa elementë të procesit mësimor siç janë: pritshmëritë e tyre për programin dhe lëndën përkatëse; njohuritë e tyre paraprake për çështjet më të rëndësishme që trajton lënda përkatëse; mënyrën se si ata e vlerësojnë lidhjen e lëndës përkatëse me lëndë të tjera të programit mësimor; rëndësisë që ka lënda përkatëse për formimin e</p>

	<p>seminareve, studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe komente. Nga ana tjetër, prezantimet e studentëve janë të organizuara në formën e diskutimeve duke i bërë klasat më tërheqëse dhe ndërvepruese.</p> <p>Ndërkohë një element shumë i rëndësishëm është pajisja e studentëve me njohuri për organizimin dhe zbatimin e lojrave sportive dhe sporteve individuale. Këto shihen si format kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve të edukimit fizik dhe sporteve.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve</p> <p>Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit EFS.</p> <p>Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSh në EFS 20-21</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Prezantimet e punimeve nga ana e studentëve, projektet, detyrat dhe punimet praktike, inkurajojnë ndjenjën e pavarësisë së studentit, punën në grup dhe të menduarit kritik. Në të njëjtën kohë ofrohet mbikqyrje dhe mbështetje nga ana e pedagogëve, duke ndërtuar kështu një mjedis bashkëpunues, në të cilin studentët mund të zhvillojnë vetëbesimin e tyre.</p> <p>Për të rritur bashkëveprimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet master zhvillohen përmes prezantimeve në grup. Kjo formë nxit përgjegjësinë dhe rrit respektin e ndërsjellë ndërmjet studentëve, rrit vetëbesimin dhe përgjegjësinë duke i motivuar më shumë ata.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 6. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve</p> <p>Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit EFS.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mesimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mesimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Procesi i mësimdhënies dhe shkencor kryhet në ambiente të përshtatshme dhe cilësore, të cilat mirëmbahen dhe ruhen si duhet. Institucioni ka kampusin e tij të ri një ndërtim modern e bashkëkohor që ka transformuar rrënjësisht cilësisht mjediset e mësimdhënies dhe të stafit administrativ. Administrata ka punësuar një kompani pastrimi që është gjithmonë e pranishme në kampus. Gjithashtu, është i punësuar një ekip me teknikë, që përkujdeset</p>

	<p>për të gjitha objektet, përfshirë materialet, sistemin elektrik, ngrohjen e të gjitha ambienteve të brendshme në dimër, ajrin e kondicionuar gjatë verës, mirëmbajtjen e mjediseve sportive. Normativat teknike të ndriçimit natyral janë konform kritereve të përcaktuara në kuadrin ligjor.</p> <p>Mjediset e brendshme të mësimdhënies janë të pajisura me teknologjinë më të fundit e cila garanton standarte të larta e bashkëkohore mësimdhënie.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën.</p> <p>Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë të pajisura me pajisjet më moderne, duke përfshirë projektorë, tabela smart, kompjuter në laboratorë dhe instrumente eksperimentale, internet në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin, bibliotekën moderne etj.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën.</p> <p>Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të ndryshme informatike dhe infrastrukturë të konsoliduar të IT-së të nevojshme për procesin e mësimdhënies. UniBa i pajis studentët dhe stafin me emaile zyrtare memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom, etj. Gjithashtu, me anë të kësaj adrese emaili, studentët aksesojnë llogarinë e tyre personale nga ku mund të ndjekin notat e tyre dhe të gjitha çështjet e tjera që lidhen me marrëdhëniet e tyre me Universitetin.</p> <p>Gjithashtu, përmes sistemit të menaxhimit të të mësuarit çdo pedagog mund të hapë një llogari lënde nga e cila pedagogu ndan shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose esse-të dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike. Kampusi ka akses në internet në të gjitha ndërtesat dhe laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me programet më të fundit windows.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën.</p> <p>Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse në ambientet e bibliotekës së Universitetit “Barleti”. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. Universiteti “Barleti” ka gjithashtu akses në një numër të konsiderueshëm bibliotekash on-line.</p>

	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në funksion të programit mësimor përbëhet nga: 1-Literatura bazë 2-Literatura ndihmëse 3-Literatura në bibliotekë 4-Literatura online 5-Literatura në intranet.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42c. Të dhëna për Bibliotekën, Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën.</p> <p>Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka ka një fond librash shumë të pasur (prej rreth 5250 titujsh) për secilin nga programet e studimit të ofruar nga Universiteti. Universiteti ofron ambiente komode për lexim dhe 2 salla studimi për më shumë se 68 studentë dhe pedagogë. Titujt e librave vlerësohen si të mjaftueshëm për përfundimin e suksesshëm të programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. Biblioteka pasurohet çdo vit. Librat e bibliotekës janë inventarizuar dhe ndarë sipas fushave dhe temave. Literatura e bibliotekës mund të gjendet në gjuhë të ndryshme si: anglisht, shqip, frëngjisht etj. Librat e blerë janë zgjedhur sipas nevojave dhe kërkesave të studentëve dhe stafit akademik.</p> <p>Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet nëpërmjet sistemit të platformës online, i cili mundëson menaxhimin e librave të kategorive të ndryshme, kontrollimin me lehtësi për lëshimin/kthimin, vonesave, humbjes apo dëmtimin e librave.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42c. Të dhëna për Bibliotekën, Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 45. Lista e teksteve në Bibliotekë të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Universiteti “Barleti” ka anëtarësim të plotë në JSTOR, një bibliotekë e përbashkët digjitale e krijuar në 1995, që përfshin më shumë se 2000 revista akademike. JSTOR u themelua për të ndihmuar bibliotekat dhe botuesit akademikë të kalojnë aktivitetet e tyre nga printimi në operacione digjitale, për të zgjeruar aksesin e teksteve shkencore në të gjithë botën, si edhe për t’i ruajtur ato për brezat e ardhshëm.</p> <p>Çdo anëtar i stafit të Universitetit “Barleti” mund të hyjë në koleksionet e JSTOR duke u futur në http://ëëë.jstor.org/ dhe duke kërkuar për materiale.</p> <p>Drejtuesit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e artikujve të bibliotekës për të mbështetur programin, përfshirë buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Studentët apo stafi akademik, përmes llogarisë personale që ka secili, mund të hyjë në platformë, dhe vetëm me një buton mund të</p>

	<p>rezervojnë ose në mungesë mund të bëjnë kërkesë për rezervimin e librit sapo të kthehet në bibliotekë. Platforma është plotësisht e automatizuar dhe i gjithë ky proces ndiqet dhe menaxhohet lehtësisht nga stafi i bibliotekës përmes postës elektronike.</p> <p>UniBa ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me disa biblioteka online siç janë EconBiz dhe Research4life, EBSCO, DOAJ etj.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42c. Të dhëna për Bibliotekën, Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron një bazë laboratorike moderne dhe të pajisur shumë cilësisht. Laboratorët janë funksionalë dhe i shërbejnë më së miri procesit mësimor, si edhe studimeve specifike. Laboratorët shfrytëzohen nga studentët nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet/softwar e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor.</p> <p>Ne si GVJ <u>sugjerojmë që në të ardhmen të mendohet seriozisht për laboratorë matjes të cilësive fizike apo parametrave fizike në mënyrë që studentët e këtij programi studimi laboratorin ta ketë krenarinë e studimeve të tyre.</u></p> <p>Kriteri përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën. Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik dhe studentët janë të pajisur me një adresë e-mail, e cila u ofron atyre mundësi komunikimi në internet, përmes veçorive të postës elektronike umb.edu.al me bazë në Google. Gjithashtu përdoren, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, Google Drive and sharing, Google Classroom etj.</p> <p>Me anë të sistemit të menaxhimit të mësimimit SIS Claster, pedagogët inkurajohen të përdorin llogarinë e tyre të lëndëve individuale, të hapura nga zyra e IT. Nëpërmjet platformës LMS pedagogët ndajnë shënimet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektet ose detyrat, kryejnë dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 42a. Raport i ekspertit për infrastrukturën. Evidenca 42b. Të dhëna për infrastrukturën. Evidenca 46. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së TIK.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe nga shqyrtimi i infrastrukturës në funksion të programit të studimit, GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët përdorin sisteme të brendshëm të komunikimit si p.sh.adresat elektronike të Universitetit “Barleti”, shkëmbimi i dokumenteve përmes Google Drive, Google Classroom, faqet e internetit të google etj.</p>

	<p>Sistemi i brendshëm më i rëndësishëm i komunikimit është ai përmes Sistemit të Menaxhimit të Mësimin, të platformës SIS Classter, të ofruar nga Universiteti, për të aksesuar dokumentat elektronike dhe profilet e tyre personale të dedikuara.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 46. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së TIK.</p> <p>Evidenca 48b. Manuali i përdorimit të portalit Studentor për administrim.</p> <p>Evidenca 48b1. Platforma WEB - Portali Studentor.</p> <p>Evidenca 48c. Procedurat & standardet WEB.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Në fillim të semestrit të katert, secili student merr temën e diplomës dhe propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës. Pas caktimit të mbikëqyrësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit, duke filluar me zgjedhjen e temës deri në përfundimin e punimit të diplomës.</p> <p>Në RGVB thuhet: <u>Studentët që arrijnë mesataren 9.5 e sipër ka të drejtë të zgjedhë temë kërkimi për provën finale. Të gjithë studentët me mesatare nën 9.5 provën finale e realizojnë me provim final!!!</u></p> <p>Ligji 80/2015 në Nenin 75 – Programet e ciklit të dytë të studimeve është i prerë për këtë pikë: “Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” përmbillen me punim diplome. Edhe në rregulloren e këtij programi studimi në Nenin 16 – Prova Finale thuhet se: Studimet mbyllen me provën finale që do të jetë në trajtën e punimit të diplomës.</p> <p>Kriteri përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Dokumenta shtesë 10. Paketa e punimit të diplomës master 2021 2022 (MP&MSc).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>Në statutin e Universitetit “Barleti” në Nenin 10 – Sigurimi i cilësisë thuhet se: Sigurimi i brendshëm i cilësisë është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë në UniBa. Sigurimi i cilësisë në UniBa realizohet nëpërmjet Njësisë së</p>

<p>mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë (NJZHKC). NJZHKC përbëhet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtuuesi i Njësisë Koordinatori për monitorimin dhe vlerësimin e procesit mësimor Koordinatori për procesin e vlerësimit të cilësisë dhe zhvillimit të kurrikulave. Koordinatori për sigurimin e standarteve dhe ndjekjen e proceseve të akreditimit. <p>Ato vlerësojnë, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozojnë ndryshime për përmirësime të nevojshme.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 2. Statuti i Universitetit Barleti. Evidenca 8. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së funksionimit të programit të studimit vërehet që Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin studimor Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Departamenti, me anë të nje programi vjetor aktivitetesh, workshop-esh dhe takimesh, synon rritjen e vetëdijes së stafit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit. Specifikisht për studentët e rinj, departamenti organizon javën e orientimit në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Stafi akademik dhe studentët janë të vetëdijshëm që janë të përfshirë në një proces vlerësimi gjatë gjithë vitit akademik dhe posaçërisht për aspektet e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 4. Plani Strategjik per zhvillimin e programit. Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit EFS. Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve - si njësia bazë për cilësinë e mësimdhënies, si dhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSSC)-si struktura kryesore në nivel institucional për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Metodat kryesore përfshijnë përfitimin e njohurive përmes teksteve të lëndës, leksioneve ppt, prezantimeve individuale dhe në grup, projekteve kërkimore, leksioneve të hapura, praktika sportive, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga fushat e aktivitetit fizik dhe sportit që vizitojnë kampusin, praktika profesionale, vizita në terren,</p>

	<p>aktivitete vullnetare, projekte dhe anëtarësime në klubet studentore dhe aktivitete të tjera jashtë shkollore.</p> <p>Kriteri përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 37. Raport vjetor i publikur per monitorimin dhe sigurimin e cilesise.</p> <p>Evidenca 38. Analize e Departamentit pergjegjes per arritjen e objektivave formuese te programit te studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion nga takimi me stafin akademik të angazhuar në programin studimor, si dhe pas shqyrtimit të CV-ve të tyre, konstatohet që personeli akademik dhe ndihmës përfshihen në projekte shkencore, projekte profesionale, seminare/ workshop-e/ konferenca në fushat përkatëse të kërkimit shkencor etj.</p> <p><u>Shumë e rëndësishme nga ana e GVJ-së konsiderohet kualifikimi i stafit akademik MSc të cilët duhet të jenë më aktivë në studime shkencore, referime apo botime si brenda ashtu edhe jashtë vendit.</u></p> <p>Botimet në revista prestigjioze të indeksuara të sportit do të ndikonin edhe në ranking të UniBA. Fakulteti në bashkëpunim me departamentin duhet të mendojnë seriozisht për konferencën e tyre shkencore.</p> <p>Ky kriter përmbushet kryesisht.</p> <p>Evidenca 43. Te dhëna te plota të aktiviteteve per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te stafit akademik në 5 vitet e fundit.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizojnë në mënyrë periodike ëorkshope dhe aktivitete të ndryshme trajnimi të mbajtura nga trajnues kombëtarë e ndërkombëtarë, në kuadër të përmirësimit të veprimtarive të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore. Këto aktivitete janë të afishuara në faqen e internetit të universitetit.</p> <p>UniBa ka krijuar e po krijon hap pas hapi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore-shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave akademike dhe Instituteve.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 39 Udhëzues për përdorimin e metodave inovative në mësimdhënies;</p> <p>Evidenca 43: Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kerkimin shkencor të stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Bazuar në Statutin e Universitetit “Barleti” si dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit të Studimit, stafi akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” si dhe stafi ndihmësakademik (Koordinatori i Departamentit, etj.) janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja përmes ndjekjes së vazhdueshme të planeve dhe strategjive të hartuara për këtë qëllim.</p>

	Ky kriter përmbushet plotësisht. <i>Evidenca 3.Strategjia e zhvillimit te Institucionit.</i> <i>Evidenca 4. Plani Strategjik per zhvillimin e programit.</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	GVJ u informua gjatë takimeve me stafin akademik të programit të studimit mbi aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat personeli akademik dhe ndihmës trajnohet dhe teston metoda të reja mësimore. Këto trajnime realizohen kryesisht në kuadër të shkëmbimeve ndërkombëtare për trajnimin e stafit, apo aktiviteteve të mirëfillta trajnuese të organizuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Universitetit dhe Departamenti. Aktivitetet trajnuese, objektivat, efektet dhe pritshmëritë analizohen dhe raportohen në strukturat përkatëse. Raportet janë të aksesueshme edhe në faqen e internetit. Ky kriter përmbushet plotësisht. <i>Evidenca 37.a Raport i vleresimit te brendshem te studenteve evidence.</i> <i>Evidenca 38. Analize e Departamentit pergjegjes per arritjen e objektivave formuese te programit te studimit.</i>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	“UniBa” gjykojmë se në vazhdimësi në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, ka zbatuar politikën e përfshirjes së lektorëve dhe kërkuesve shkencorë në faza të ndryshme të procesit mësimor si elemente të rëndësishëm për shkëmbimin e ideve dhe metodave të mësimdhënies. Të ftuarit kanë qënë nga shumë fusha dhe të mirënjohur për ekspertizën apo eksperiencën e tyre. Ky kriter përmbushet plotësisht. <i>Evidenca shtesë 12. Mbi leksionet e hapura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen	Universiteti i pajis studentët me udhëzuesin e Studentëve, i cili informon studentët për të gjitha rregulloret, proceset, politikat dhe mekanizmat që udhëheqin studimet e tyre. Ky dokument është i publikuar edhe ne faqen e zyrtare të Universitetit. Rregullorja e institucionit/programit parashikon

<p>publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>në mënyrë të qartë modalitetin e vlerësimit. Procesi i vlerësimit përfshin një shumatorë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësha specifike e komponentëve të vlerësimit është specifike dhe ndryshon nga lenda në lëndë. Në përgjithësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 % ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive - 10 % plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit, essetë) - 30 % testimet gjatë vitit - 50 % provimi përfundimtar. <p>Rregullorja akademike, rregullorja e programit dhe silabusi i lëndës njoftohen për të gjithë studentët në fillim të çdo viti akademik dhe shpjegohen për çdo rast në varësi të kërkesave gjatë vitit akademik.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5: Rregullore Universitetit Barleti; Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte; Evidenca 14.3 mënyra e vlerësimit të studentëve. Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSH ne EFS 20-21</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në javën e parë të semestrit akademik, pedagogu informon studentët mbi programin lëndor, i cili përmban informacion mbi: përmbajtjen e lëndës të organizuar në javë, objektivat e lëndës, rezultatet e të nxëniet të lëndës, literaturën bazë dhe të rekomanduar dhe materialet e tjera të lëndës, metodën e vlerësimit të lëndës, shpërndarjen e ngarkesës së bashku me afatet për secilin detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës.</p> <p>Përgjatë vizitës në institucion dhe gjatë intervistave me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi lehtësitë e marrjes së informacionit nga ana e studentëve.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte; Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSH ne EFS 20-21</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Sipas shqyrtimit të syllabuseve të lëndëve në programin studimor, si dhe dhe takimit me studentët, njohuritë dhe aftësitë e studentëve vlerësohen përmes këtyre formave kryesore: 1) provim i ndërmjetëm, 2) prezantim 3) projekt 4) projekte praktike, 5) esse, 6) projekte semestrare, 7) provim përfundimtar 8) pjesëmarrje aktive.</p> <p>Vlerësimi përmbledhës realizohet me test përmbledhës në fund të vitit akademik.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5: Rregullore e Universitetit “Barleti”; Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.6**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Tek Rregullorja e programit të studimit në Nenin 17 – Krihere dhe procedura vlerësimi thuhet se: “Kriteret dhe format e vlerësimit të studentit përcaktohen në planin mësimor (kurrikula), në programin (syllabusin) e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve. Vlerësimi i një lënde mund të bëhet: a) me provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi, projekte, postera; c) i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS nga shkronja A deri në F). Vlerësimi me notë është i detyrueshëm. Nota kaluese konsiderohen nga 5 e lart dhe shkronjat nga A deri E. Ky kriter përmbushet plotësisht. Evidenca 5: Rregullore Universiteti “Barleti”; Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatojmë që, në përgjithësi, provimet janë në formatin e provimeve të bazuara në letër, zhvillohen dhe vlerësohen në mënyrë anonime. Detyrat, projektet, dorëzohen në mënyrë elektronike dhe/ose të printuar tek pedagogu përkatës. Në të dy rastet, sekretaria hedh notat në rregjistrin përkatës elektronik. Studenti fiton të drejtën e dhënies së provimit të një lënde kur ka qenë i pranishëm në masën e detyrueshme në leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat sipas përcaktimit në Nenin 72 të Rregullores për funksionimin e Sekretarisë Mësimore. Gjatë periudhës së pandemisë institucioni ka përdorur platforma dhe sisteme online si google classroom ku janë përfshirë edhe module të vlerësimit elektronik. Në projektet për të ardhmen parashikohet të zgjerohet zbatimi i testimit online krahas proceseve të tjera të mësimdhënies. Ky kriter përmbushet plotësisht. Evidenca 9. Rregullore për Funksionimin e Sekretarisë Mësimore. Evidenca 39a: Manual i mësimdhënies online 2019-2020 Evidenca 39.b: Guidë instruktive e mësimi on-line 2020- 2021.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregulloreves së programit të studimit konstatojmë se provimet vlerësohen nga pedagogu/pedagogët që kanë zhvilluar lëndën. Hartimi i testit përmbledhës miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Fleta e vlerësimit firmoset nga përgjegjësi i departamentit dhe kryesekretari.</p>

<p>paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Është e drejta e studentit që nëse është i paqartë ose ka pakënaqësi për vlerësimin nga ana e pedagogut apo komisionit, të ankohet me shkrim për notën në lëndën në afat prej tri (3) ditësh nga data e komunikimit të notës pas përfundimit të lëndës, por para shënimit të notës në rregjistrin e arritjeve akademike.</p> <p>Ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e provimeve në anonimat të plotë. Aplikohet kodifikimi i fletëve të provimit, mbikqyrja e sallave nga disa vëzhgues të emëruar nga fakulteti, dhe një sistem kamerash sigurie të cilat sigurojnë evidenca në raste të vecanta parregullsie (sipas rregullores së provimeve në fuqi).</p> <p>Kodifikimi para provimit dhe dekodimi i tezave bëhet nga sekretaria mësimore.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Evidenca 9. Rregullore per Funkcionimin e Sekretarise Mesimore.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentit, përveç vlerësimit me pike/notë, shoqërohet me komente, veçanërisht në projekte, prezantime dhe forma të tjera të ngjashme vlerësimi. Gjatë takimit që patëm me studentët e programit u vu re perceptimi pozitiv mbi komentet, këshillat dhe rekomandimet e pedagogeve në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen.</p> <p>Për zhvillimin e testit përfundimtar zhvillohet paraprakisht një seancë sqaruese me studentët, bëhet përmbledhje e temave dhe koncepteve kryesore të trajtuara dhe bëhet shpjegimi i kriterëve të vlerësimit.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 70. Formati i tezës.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti, nëpërmjet rregullores mbi disiplinën e studentëve, dënon kopjen dhe plagjiaturën. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Përveç rregullores së shkruar, universiteti përdor mekanizma që kontrollojnë plagjiaturën për detyrat me shkrim e sidomos temat e diplomave si detyrime përmbyllëse.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5: Rregullore Universiteti Barleti, Neni 73,74;</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive</p>	<p>Afatet e përfundimit të vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale janë</p>

<p>profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>të përcaktuara qarte dhe të shpallura në kalendarin akademik të universitetit. Finalizimi i notave realizohet me anë të sistemit elektronik, në përgjithësi maksimalisht 10 ditë pas periudhës së provimit përfundimtar.</p> <p>Dosja e provimit është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare.</p> <p>Fleta e vlerësimit firmoset nga përgjegjësi i departamentit dhe kryesekretari.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregulloret e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit si dhe nga vizita në universitet u konstatua se studentët e ushtrojnë të drejtën e tyre për të kundërshtuar rezultatin e një vlerësimi duke paraqitur një ankese në sekretarinë mësimore në bashkëveprim edhe me Dekanen e studentëve me anë të një formulari të veçantë, brenda 3 ditëve pas shpalljes së notave përfundimtare por para shënimit të notës në Regjistrin e arritjeve akademike.</p> <p>Pedagogu i lëndës i shpall notat në mënyrë jo zyrtare para se t'i regjistrojë të njëjtat, me qëllim që t'u jepet mundësia studentëve për shpjegim lidhur me notat e vendosura.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregulloret e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Pas shqyrtimit të rregulloreve dhe komunikimit me studentët gjatë programit të vizitave në institucion GVJ konstaton se studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e marrë dhe të marrë përgjigje sipas rregullave të përcaktuara. Në rastet kur pedagogu refuzon ndryshimin ose nuk kontaktohet dot, studenti bën një ankimim dhe ankesa i drejtohet përgjegjësit të departamentit i cili ngre një komision për shqyrtimin e ankesës. Pedagogu i modulit/ lëndës, duhet t'i sigurojë të gjitha dëshmitë për vlerësimin e studentit (testin, punimet etj). Vendimi i Komisionit të Rivlerësimit është përfundimtar dhe dokumentacioni bashkë me rezultatin dorëzohet e arkivohet në sekretarinë mësimore.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregulloret e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.7


Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

60

studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të dytë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e tretë, për ata student që kanë rezultatet më të larta dhe kanë synime të qarta drejt akademizmit.</p> <p>Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet punëve të pavarura dhe praktikave. Përveç kurrikulës, studentët marrin pjesë rregullisht në aktivitete jashtë kurrikulare, siç janë forume të hapura, vizita në terren, konferenca studentore etj.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>10% e kurrikulës është e përbërë nga lëndë të tipit D, që garantojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p> <p>Programi përmban lëndë si: metodat sasiore dhe cilësore të kërkimit shkencor, higjenë sportive dhe dietologji, neurofiziologji dhe endokrinologji e lëvizjes dhe edukim shëndetësor.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 14: Plani mësimor i Masterit të Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte;</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde përmbledhen, analizohen e shqyrtohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde.</p> <p>Në analizat e departamentit është praktikë pune që shqyrtohet gjerësisht niveli i kompetencave profesionale të fituara nga studentët në përfundim të lëndëve, sfidat në arritjen e tyre, efektiviteti i metodave të zbatuara në mësimdhënie, përfshirja dhe aktivizimi i studentëve në mësimdhënie dhe të nxënë.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 38: Analizë e DEFS mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit;</p> <p>Evidenca 41: Pyetësor i stafit akademik dhe ndihmës akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe</p>	<p>Leksionet zhvillohen kryesisht duke kombinuar metodën tradicionale të shkrimit në tabelë me prezantime interaktive ppt. Këto shënime dhe përmbledhje leksionesh ndahen më studentët javë pas javë.</p> <p>Me përfundimin e lëndës pedagogu përgjegjës jep një pasqyrë të</p>

<p>testin përfundimtar.</p>	<p>saktë mbi formatin mbi të cilën do të ndërtohet provimi përfundimtar. Studentët para këtij provimi kanë zhvilluar provimin e ndërmjetëm pra janë njohur me strukturën e provimit pasi provimi përfundimtar ka të njëjtën strukturë dhe format.</p> <p>Kjo mundëson që studentët janë të qartësuar me gjithshka ka lidhje me provimin përfundimtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - llojin dhe numrin e pyetjeve, - nivelet e vështirësisë së pyetjeve dhe - pjesët e programit që përfaqësojnë, - kohën e testit dhe - mënyrën e vlerësimit të përgjigjeve. <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve; Evidenca 41: Pyetesor i stafit akademik dhe ndihmës akademik; Evidenca 5: Rregullore akademike.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete shkencore, prezanton punën e tyre në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë dhe organizon ëorkshope, si dhe zhvillon leksione në institucione të ndryshme.</p> <p>Stafi akademik kryesisht ai me tituj e grada zhvillon “open inovation” në lidhjet e tij të ngushta me bizneset dhe industrinë.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 74. Plan Veprimi i departamentit.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në UniBa realizohet mbi bazë kompetencash, te cilat janë të mirëpercaktuara në programet lëndore. Studentët e programit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e marra në laboratorët kompjuterikë, në laboratorët e biologjisë e kimisë, si dhe në praktikat profesionale.</p> <p>Praktika profesionale parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e studimeve për programin Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte - Nenet 3 dhe 18; Evidenca 76; Format pakete praktike Masteri Shkencave dhe Profesional ne mesuesi e edukim fizik dhe sporte. Korrik 2020</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme është listuar si një ndër kompetencat e programit Master i Shkencave në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”.</p> <p>Nëpërmjet punës në grup apo fokus grupeve UniBa synon të zhvillojë aftësi të tilla, si: arsyetimi, zgjidhja e problemeve, mbajtja e</p>

	qëndrimeve; aftësi interpersonale si: të dëgjuarit, të folurit, bashkëbisedimi, drejtimi. Ky kriter përmbushet plotësisht. Evidenca 19. Plani mesimor dhe syllabe MSH ne EFS 20-21								
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Nga vizita në UniBa konstatoam se studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Stafi akademik i inkurajon studentët të zhvillojnë ide dhe t'i bëjnë të zbatueshme ato në fushat përkatëse dhe profesionin e tyre si mësues të edukimit fizik, por edhe në fushën e akademizmit. Ky kriter përmbushet plotësisht. Evidenca 37.a Raport i vleresimit te brendshem te studenteve evidence.								
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	GVJ konstaton pas takimit me studentët se ata inkurajohen të zhvillojnë ide inovative të natyrës teknike, shkencore, por edhe sociale. Universiteti, me anë të Dekanatit të Studentëve, u ofron studentëve mundësinë për t'u bashkuar me klubet studentore dhe për të zhvilluar dhe promovuar idetë e tyre inovative dhe aftësi të tjera, duke i mbështetur ato edhe financiarisht. Ky kriter përmbushet plotësisht. Evidenca 8. Rregullore e Njesise se Zhvillimit te Kurrikulave dhe Cilesise.								
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	Institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bilaterale për shkëmbimin e studentëve, lista e të cilave është vënë në dispozicion të GVJ. Universiteti Barleti në kuadër të programit Erasmus+ student mobility, shkëmben studentë me: Universita degli Studi di Genova, Itali Universitetin e Vico, Catalonia, Spanjë Universitetin Politeknik të Barit, Itali, por <u>Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve duhet të krijojë kontaktet dhe netëork-un e vet në mënyrë që edhe studentët e programeve të studimit të sporteve të fillojnë me mobilitetet në universitetet partnere kryesisht në Europë.</u> Ky kriter përmbushet kryesisht. Evidenca 17. B. Lista e Marrëveshjeve për mobilitetin e studentëve. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit dhe studentëve.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gimn. «Q. Stafë», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

63

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Procedura për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve është e hartuar qartë dhe e publikuar në faqen e internetit, nga ku studentët mund ta aksesojnë lehtësisht.</p> <p>UniBa ka hartuar Paketën e Punimit të Diplomës ku jepen udhëzime për procedurat e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës.</p> <p>Kjo paketë përmban udhëzime për procedurat e përgatitjes, të udhëheqjes, të monitorimit, të prezantimit dhe të vlerësimit të punimit të diplomës; përmban përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në realizimin e kësaj veprimtarie.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave ne mesuesi ne edukim fizik dhe sport.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Informacioni dhe udhëzimet mbi provimin final dhe mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve në UniBa është i publikuar. Pedagogët përgjegjës plotësojnë një program lëndor (syllabus-et) për lëndën e provimit të përgjithshëm përfundimtar, si dhe për projektin e diplomimit dhe i shpërndajnë ato tek studentët në fillim të semestrit.</p> <p>Nga vizita në universitet, vërehet qe studentët përzgjedhin lektorin sipas fushave të interesit. Pedagogët punojnë me studentët e caktuar përkatësisht në mënyrë të pavarur dhe ndajnë me to të gjitha materialet që mund t'i ndihmojnë ato të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave ne mesuesi ne edukim fizik dhe sport.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Provimi final është i përbërë nga grupe të ndryshme pyetjesh të përgatitura nga lëndët teknike që studentët kanë ndjekur gjatë studimeve të tyre master shkencor. Përqindja e secilit grup pyetjesh përcaktohet në bazë të ngarkesës së tyre ECTS në kurrikul dhe raportit të tyre me lëndët e tjera. Komisioni i Departamentit përgatit provimin final bazuar në pyetjet e paraqitura nga secili pedagog i përfshirë në proces, sipas përqindjes së përcaktuar.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 6b. Rregullore e Departamentit EFS.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Brenda 3 muajve nga data e fillimit të vitit akademik, departamenti u bën të njohur studentëve të vitit të dytë temat orientuese të diplomave, me anën e të cilave do të bëhet vlerësimi përfundimtar, në përputhje me fushën e studimit.</p> <p>Studentët brenda muajit janar paraqesin në departament kërkesat dhe propozimet për temat e zgjedhura dhe udhëheqësin. Propozimet diskutohen dhe miratohen në departament nëpërmjet një vendimi që u komunikohet studentëve.</p>

	<p>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, udhëzon dhe ndihmon studentët rreth temave dhe njohurive që do të testohen në provimin final.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave në mesuesi në edukim fizik dhe sporte.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Universiteti ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme, si dhe staf ndihmës për të asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve të ndryshme.</p> <p>Pegagogu udhëheqës mban kontakte të vazhdueshme me studentin diplomant 2-3 orë në javë dhe e asiston edhe në laborator apo mjedis sportive për realizimin e matjeve apo testeve.</p> <p><u>GVJ rithekson që në zbatim të Ligjit 80/2015 të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë çdo student i Masterit Shkencor duhet ti përmbyllë detyrimet me mbrojtje teme diplome pavarësisht nga nota mesatare në dalje.</u></p> <p><u>Ky kriter përmbushet kryesisht.</u></p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave në mesuesi në edukim fizik dhe sporte.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas paketës së punimit të diplomës udhëheqësi i diplomës garanton mbi zbatimin e të gjitha rregullave të përcaktuara në këtë paketë. Ai jep mbështetjen akademike dhe konsulencën e nevojshme që ti mundësojë kandidatit të arrijë standarte të larta të punimit, ndihmën për formulimin e titullit, përgatitjen e platformës së punimit, rekomandimin e literatures, konsulencën për përgatitjen e punimit.</p> <p>Udhëheqësi ka përgjegjësinë të ndërgjegjësojë studentin për falsifikimet dhe plagjiaturën dhe të monitorojë cdo procedurë e cila duhet të jetë në përputhje me standartet e përcaktuara. Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave në mesuesi në edukim fizik dhe sporte.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Komiteti Shkencor i programit përkatës i propozon përgjegjësit të njësisë bazë Komisionin e Vlerësimit me një përshkrim të shkurtër për anëtarët e tij. Titullari i njësisë kryesore miraton Komisionin e Vlerësimit me propozimin e njësisë bazë. Komisioni përbëhet nga 3 pedagogë ose specialist të fushës. Ata duhet të jenë me tituj dhe grada. Për vlerësimin e diplomës anëtarët e komisionit të vlerësimit mbajnë parasysh këto kritere:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstrimin e një vetëdije profesionale në trajtimin e temës së zgjedhur; - përdorimin e metodologjisë shkencore dhe të instrumenteve të kërkimit; origjinalitetin e punimit; - dobinë e punimit; - cilësinë e të shkruarit (respektimi i stilit shkencor të të shkruarit, respektimi i rregullave të drejtshkrimit);

	<ul style="list-style-type: none"> - paraqitjen e qartë dhe formimin e një tërësie koherente; - (respektimi i kërkesave të formatit dhe kërkesave teknike); - cilësinë e prezantimit. <p>Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 78. Paketë e punimit të diplomës Master i Shkencave ne mesuesi ne edukim fizik dhe sporte.</p>								
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 ECTS dhe mbrojtjen e diplomës, zyrat përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Zyra e Regjistrimit të Universitetit pajis studentët e diplomuar me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas formateve të liçensuara dhe të aprovuara nga MAS.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</p>								
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentët mund ta aksesojnë programin e zhvilluar në çdo moment, nëpërmjet sistemit interaktiv. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të zhvilluar Master Shkencor në Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</p>								
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen</p>	<p>Universiteti arkivon dokumentacionin e studentit pas diplomimit në zyrat e arkivës. Rast pas rasti, bazuar në kërkesat specifike të studentëve, lëshohen vërtetime për qëllime të ndryshme.</p> <p>Ky kriter përmbushet plotësisht.</p> <p>Evidenca 5. Rregullore e Universitetit Barleti.</p> <p>Evidenca 7. Rregullore programi MSH - Mesuesi ne edukim Fizik dhe Sporte.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

66

përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore <i>(Evidencë 11)</i> Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DEFS. Bazuar ne kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit <i>(Evidencë 11)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga shqyrtimi i RVB, (Evidence RVB), si dhe takimi me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore konstatuam që , institucioni zbaton procedura ligjore për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit të studimit. DEFS në bashkëpunim me Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, harton procedurat për shpalljen e thirrjes online, përgatitjes së komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kriterëve të përcaktuara në bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të Rregullores së institucionit. <i>(Evidencë 5), (Evidencë 11)</i> . Rezulton se institucioni është angazhuar për krijimin e mjedisëve të përshtatshme për personelin akademik e ndihmës akademik me sipërfaqe duke ndërtuar Kampusin e Ri. Siperfaqja për personelin akademik e ndihmës akademik është 320m2. <i>(Evidencë 42a & 42b)</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Konstatuam se , Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DEFS. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe të marrëveshjeve të nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit. <i>(Evidencë 11)</i> Stafi akademik është i angazhuar për kualifikim të vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit. <i>(Evidencë 43)</i> Gjithashtu, institucioni ka organizuar leksione të hapura, në kuadër të zhvillimit pedagogjik. <i>(Evidence Dok. Shtesë 12)</i>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të	Konstatojmë se , institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm, (Evidencë 43), dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies si dhe të përdorimit të teknologjive të reja si platforma Google Classroom, Google Hangouts Meet, etj.

teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.	<i>(Evidencë 39b)</i>			
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë	Institucioni dhe DEFS, dëshmojnë të kenë burimeve njerëzore të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master Shkencor Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte <i>(Evidencë 23 & 25)</i> dhe mjedise të përshtatshme për krijimin mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale <i>(Evidencë 42b)</i> . DEFS, në çdo fillim viti akademik, planifikon paraprakisht ngarkesën mësimore për çdo anëtar të personelit akademik të departamentit si dhe ndjekjen e politikave për rekrutimin e pesonelit të nevojshëm për plotësimin e objektivave mësimore të këtij program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kwrkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatuam se , lëndët e programit Master Shkencor Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte zhvillohen në Kampusin e ri 2 të Universitetit Barleti. <i>(Evidencë 42a)</i> Infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike. <i>(Evidencë 42b)</i> Të gjitha auditorët janë të pajisura me kompjuter dhe video-projektorë si dhe ekrane, të cilët mundësojnë mësimdhënien me metoda të ndryshme si power-point, imazheri etj. Auditorët gjithashtu janë të pajisur me mjetet e nevojshme didaktike, për të zhvilluar veprimtaritë mësimdhënëse teorike dhe praktike. Infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mëdha dhe me kushte të mira fizike. <i>(Evidencë 42b)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive	Konstatuam se disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. FSHSTS ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Master Shkencor Mësuesi në

bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Edukim Fizik dhe Sporte, duke përbushur kështu standardet e duhura 7.08 M2 për student. <i>(Evidencë Vizita e GVJ-së në UniBa 42a & 42b)</i>		
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita e mjediseve konstatuam se , auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banga, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj.). Sallat e leksioneve në të cilat zhvillohen lëndët e programit të studimit janë të pajisura me videoprojektorë. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion konstatuam se mjediset mësimore si zyra, salla leksionesh, laboratorë, sallë konferencash janë të pajisuara me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe detyrat praktike formues të programit të studimit.		
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në terren, konstatuam se , laboratorit i informatikës është i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet prej 30 vëndesh. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UniBa-së gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik. <i>(Vizita e GVJ-së në UniBa)</i>		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Konfirmojmë që , institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore parauniversitare, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit Master Shkencor Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte. <i>(Evidence 34)</i> Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, UniBa ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike apo veprimtari të posaçme vetë ose edhe në bashkëpunim me institucione të tjera. Ky fakt, u evidentua nga GVJ edhe gjatë vizitës në institucion.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion konstatoam se, biblioteka është e konceptuar në disa mjedise të ndërlidhura së bashku. Një mjedis ku janë vendosur librat universitarë, me dy ulëse me pajisje teknologjike e lidhur me një open space, si dhe 18 ulëse leximi ku studentët kanë mundësi të ulen dhe të shfrytëzojnë literaturën. (Evidencë 42a)</p> <p>Gjithashtu një mjedis tjetër i hapur, vendosur në godinën 2, është konceptuar si sallë qendrimi dhe leximi për librat artistikë. (Evidencë 42a)</p> <p>Gjate vizitës, konstatoam që, biblioteka nuk funksionon me kartelë regjistrimi, por vetëm me kërkesa online të studentëve të cilët paraqesin kërkesën e tyre për shfrytëzimin e librave.</p> <p>Studentët kanë të drejtë të regjistrohen dhe të përdorin literaturën e nevojshme në mjediset e bibliotekës, si dhe të tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim jashtë mjedisëve të bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarije mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se, biblioteka ka në dispozicion një fond librash me 60 tituj fizikë, lidhur me programin e studimit Master Shkencor Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte në gjuhë shqipe. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjet me bibliotekat dhe database ndërkombëtare, disponohet një akses i nevojshëm, për botimet në gjuhë të huaj, lidhur me programin e studimit, duke plotësuar rekomandimin e lënë nga akreditimi i mëparshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, menaxhimi i librave të bibliotekës realizohet nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p> <p>Institucioni, i ofron studentëve, nëpërmjet linqeve që gjenden në platformë, akses në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz, JSTOR, Research4life me të cilën institucioni ka edhe një marrëveshje bashkëpunimi. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Rezulton se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesim e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. (Evidencë Dok. Shtesë 16)</p> <p>Institucioni, i ofron studentëve, nëpërmjet linqeve që gjenden në platformë, akses në bibliotekat online ndërkombëtare si: Econbiz,</p>

	JSTOR, Research4life me të cilën inistitucioni ka edhe një marrëveshje bashkëpunimi. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 16)</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Gjatë vizitës, konstatuam që , biblioteka nuk funksionon me kartelë regjistrimi, por vetëm me kërkesa online të studentëve të cilët paraqesin kërkesën e tyre për shfytëzimin e librave biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve orare shërbimi, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon gjatë orarit 08:00-16:00 nga e hëna në të premte.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Konstatojmë se , UniBa përdor sistemin Portali Studentor. <i>(Evidencë 48b1)</i> Gjithashtu konstatuam që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore: <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik; • të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Bazuar në Raportin Vjetor të DEFS, rezulton se , institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik. <i>(Evidencë 24, 25, 37 dhe 43)</i> Ndërsa në listën e marrëveshjeve në funksion të programit të studimit shprehet qartë aktiviteti që institucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij programi studimi siç janë 88 institucione të arsimit parauniversitar, në rang vendi. <i>(Evidencë 32)</i> . Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e	Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatuam se , ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në formatin e Regjistrimit

programit të studimit.	Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit. <i>(Evidencë 9)</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nëpërmjet sistemit Portali Studentor <i>(Evidencë 48b1)</i> , rezulton se, institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj. <i>(Evidencë 9)</i>			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nëpërmjet Planit Strategjik të Institucionit UniBa, <i>(Evidencë 3)</i> dhe të dhënave për konferencat dhe trajnimet <i>(Evidencë 43)</i> , rezulton se, institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative, si dhe të monitorimit të hedhjes në kohë të dokumentacionit të kërkuar lidhur me përmbushjen dhe zhvillimin e aktiviteteve mësimore.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Konfirmojmë që , në faqen zyrtare të internetit të UniBa janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendari akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UniBa, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Konstatojmë që , institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar i cili miratohet nga Senati akademik dhe Administratori, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit. <i>(Evidencë 50 & 50a)</i> . UniBa, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport, pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to

	përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, etj.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi, por, në Planin e Analizës së Tregut të Punës, për këtë program studimi, trajtohet teorikisht, tangent, raporti kosto/përfitime, pa përcaktuar vlerat e këtij raporti. <i>(Evidencë 16)</i> <i>Rekomandojme që: Institucioni të hartojë planin financiar të Programit të studimit Master Shkencor Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte, ku të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga shqyrtimi i RVB rezulton se, procedura për hartimin dhe miratimin e projekt buxhetit afatmesëm fillojnë në gjysmën e dytë të vitit akademik, pasi janë marrë parasysh nevojat e njëjësive kryesore të institucionit <i>(Evidencë RVB).</i>
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Konstatojmë se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik lidhur me bilancin e vënë në dispozicion, në rang IAL-je, edhe mbi bazën e programit të studimit, <i>(Evidencë 49 dhe 50),</i> por është i rëndësishëm edhe pasqyrimi lidhur me kërkesat e tregut të punës, bazuar mbi analizën përkatëse.
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka	Konstatojmë se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni, (Evidencë 49), dëshmon se UniBa garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë

kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	program			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomiminnë programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Rezulton se, institucioni zbaton politika për kriteret e pranimit dhe transferimit bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019 “Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 11, datë 02.06.2021 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Konstatohet që, institucioni ka ngritur komisionet përkatëse, pranë departamentit, ku nëpërmjet Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve ka hartuar politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student, në këtë program studimi. <i>(Evidencë 7 & 9)</i> Konfirmohet që, procedurat dhe kriteret e pranimit janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e hartuara nga institucioni.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë	Rezulton se, përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni, me propozim nga DEFS dhe miratim nga Senati Akademik, harton kriteret

kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, duke garantuar shanse të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, si dhe personat me aftësi të veçanta. <i>(Evidencë 7.V.24)</i>			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Konstatojmë se, institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron UniBa, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online. UniBa, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për student për programet dhe mundësitë për studim që ofron. <i>(Evidencë 7)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Rezulton se, institucioni, përpara fillimit të çdo viti akademik publikon online kriteret e pranimit për secilin program studimi. (https://umb.edu.al/program-studimi/master-shkencor/msc-mesuesi-ne-edukim-fizik-e-sporte.html) Plani i programit të studimit i bëhet e ditur studentit që në momentin e regjistrimit. Në faqen e internetit të UniBa, gjendet në çdo kohë “Broshura UniBa”. https://umb.edu.al/upload/styudiesbroshures/BROSHURA_UNIBA_22-PRILL-2021.pdf			
Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Periudha më e përshtateshme për informimin e të interesuarve për ndjekjen e këtij programi është në simestrin e dytë e mbrapa, për t’ju dhënë mundësi individëve që të qartësohen në atë çfarë do të zgjedhin. Forma të tjera të promovimit të programit Master Shkencor në Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Sporte janë si: broshura, fletëpalosje, të cilat publikohen në faqen web, në ambjentet e institucionit si edhe në media të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në	Konstatojmë që, programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përmban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të UniBa, sipas fakulteteve përkatëse (https://fshsts.umb.edu.al)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

76

tjetrin.	<p>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritetë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. <i>(Evidencë 65)</i> • Rregullorja e Programit të Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. <i>(Evidencë 7)</i> • Sillabuset e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit tyre në programin e studimit. <i>(Evidencë 19)</i> • Kurrikulën e Programit të Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. <i>(Evidencë 14 & 14.2)</i> • Kalendari akademik në të cilën përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura, diplomimet etj. (https://umb.edu.al/kalendari-akademik.html)
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Nëpërmjet Rregullores së Programit të Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe prapun e kalimit të vitit akademik, <i>(Evidencë 7)</i>, si dhe manuali i rekrutimeve, aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretaritetë mësimore, periudhën dhe kohëzgjatjen e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. <i>(Evidencë 65)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatojmë se, bazuar në Rregulloren e UniBa, <i>(Evidencë 5)</i>, në Manualin e Studentit, <i>(Evidencë 65)</i>, si dhe sillabuset, <i>(Evidencë 19)</i> e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre në programin e studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, <i>(Evidencë 7)</i>, janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit në këtë program studimi. Në fillim të semestrit të dytë, studentëve u vihet në dispozicion paketa e</p>

studimit.	punimit per hartimin e temës së diplomës. <i>(Evidencë 78)</i>		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga shqyrtimi i RVB, si dhe vizitat në institucion, u informuam se DEFS, në fillim të vitit të parë të studimeve në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, organizon javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. <i>(Evidencë 51)</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Konstatohet që, nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. <i>(Evidencë 65)</i> Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet Portali Studentor, <i>(Evidencë 48.b1)</i> , si dhe Google Classroom. <i>(Evidencë 48.c2)</i> Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, lëndët/modulet dhe ngarkesat përkatëse, silabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Rezulton se, në fillim të vitit akademik studentët pajisen me materiale udhëzuese si Manuali i Studentit, <i>(Evidencë 65)</i> , dhe Rregullorja e Programit të Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, <i>(Evidencë 7)</i> , përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen gjithashtu edhe në Strukturën e Vitit Akademik dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik, të cilat publikohen në faqen zyrtare të UniBa.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt	Konstatohet se, Zyra Karrierës dhe Alumnit, informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale, të tregut të punës, duke kryer edhe trajnime për të diplomuarit dhe informimit të tyre për kërkesat e tregut, lidhur me programin e studimit. <i>(Evidencë</i>

dhe në tregun e punës.	Dok. Shtesë 9.11.12)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Çdo fillim të vitit të parë të studimeve, DEFS, në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni, organizojnë javën orientuese me studentët e rinj gjatë të cilit prezantohet stafi akademik i përfshirë në programin e studimit, jepet informacion rreth plan programit dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës. (Evidencë 51) Në faqen e internetit të UniBa, gjithashtu gjendet i publikuar informacioni i plotë për strukturat e UniBa dhe funksionin e tyre, departamentet e ndryshme, sekretariatë mësimore, bibliotekën, laboratorët etj.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Konstatohet se, informimi i studentëve, realizohet nëpërmjet Portali Studentor, (Evidencë 48.b1) , si dhe Google Classroom, (Evidencë 48.c2) , sikurse pohuan edhe vetë studentët gjatë takimit fizik, arrijnë të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor. Ndërsa informacioni mbi kurrikulat e studimit, aktivitetet dhe kalendarin mësimor publikohen online dhe janë lehtësisht të arritshëm nga studentët në distancë.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Konstatohet se, UniBa përdor sistemin Portali Studentor (Evidencë 48b1). Gjithashtu konstatojmë që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore: <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik; • të dhëna për transferimet dhe rregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Programit, (Evidencë B) , konstatohet se, institucioni paraqet raporte vjetore për veprimtarinë e kryer. Konstatohet gjithashtu, që institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për secilin program studimi që

	<p>UniBa ofron, specifikisht për Programin e Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, rezultojnë të regjistruar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2018-2019 në total 24 studentë; • për vitin akademik 2019-2020 në total 27 studentë; • për vitin akademik 2020-2021 në total 32 studentë; <p>Numri total i të diplomuarve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për vitin akademik 2018-2020 në total 21 studentë; • për vitin akademik 2019-2021 në total 21 studentë;
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e UniBa, (<i>Evidencë 5</i>), rezulton se, Sekretaria Mësimore është zyra e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët.</p> <p>Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore konstatuam se, ajo disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatë hyrëse dhe dalëse, gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi. (<i>Evidencë 28</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Nga vizita në institucion me përfaqësues të Zyrës e Karrierës dhe Alumnit (ZKA) konstatuam se, ajo mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. (<i>Evidencë 69</i>)</p> <p>Rezulton se ZKA, bazuar edhe në Rregulloren e ZKA, ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike, mobilitet studentor si dhe informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo/edhe aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet edhe trajnimeve që kryen me të diplomuarit. (<i>Evidence 9.11.12</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga takimi në IAL, konstatuam se, sekretaria mësimore, disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu, ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit vit akademik, transferimet dhe rregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit.</p> <p>Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në platformën digjitale.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të</p>	<p>Konstatojmë se, institucioni harton në mënyrë periodike raporte</p>

hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	vjetore në rang IAL-je, për veprimtarinë e kryer. <i>(Evidencë 38)</i> Sekretaria Mësimore, gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalje, si dhe punësimit të tyre. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 6 & 9)</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Konstatojmë që, studentët e UniBa janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësimin mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Këshillin e Etikës si dhe në NjZHKC. <i>(Evidencë Plan i punës i NjZHKC)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Rezulton që, institucioni është i angazhuar që të garantojë përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve në Senatin Akademik, në grupin e ngritur nga NjZHKC për hartimin e GVB në kuadër të sigurimit të cilësisë. <i>(Evidencë Plan i punës i NjZHKC).</i> Gjithashtu, një nga strukturat e ngritura në UniBa është edhe Këshilli i Studentëve.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Rezulton se, institucioni gjatë hartimit të programit të studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” ka respektuar Ligjin Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe VKM nr. 41/2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, jo më shumë se 25 orë mësimore në javë. <i>(Evidencë 14 & 14.2)</i> Sasia mesatare e punës së kryer gjatë Programit të Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit për çdo vit akademik. Në Programin e Studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, studentët zhvillojnë 933 orë në auditor dhe 2067 orë punë


	të pavarur.			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Rezultoni se, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes pyetësorëve të studentëve. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, kryen anketime cdo semester, cdo vit me secilin grup, të cilët i shërbejnë cilësisë së mësimdhënies. Studentet njoftohen për rezultatet e vlerësimeve të tyre për çeshtje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mesimdhënies. Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia dhe pedagogët përkatës për të rishikuar lëndën dhe për të përmirësuar mësimdhënien. Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikula dhe përmirësime të niveleve të shërbimit.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e procesit mësimor, nga stafi akademik, si dhe pyetësi për studentët (<i>Evidencë 37</i>), studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	Konstatohet se Personeli akademik i programit të studimit publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplina përkatëse. Këto punë kërkimore raportohen në bazë vjetore në departament, si edhe pasqyrohen në raportin vjetor të departamentit. <i>Evidenca 38: Analiza vjetore e Dep EFS</i>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	Konstatohet që, UniBa, ka realizuar marrëveshje në kuader të mobilitetit të studenteve, projekteve dhe shkëmbimit të personelit akademik, duke bërë të mundur angazhimin e këtyre strukturave në kuader të rritjes së cilësive akademike. (<i>Evidencë 17B</i>)
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	Konstatohet se, nëpërmjet Zyra e Rekrutimit, Pranimi dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës, (<i>Evidencë 12</i>), kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës së tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve

	informuese, tryezave të rumbullakëta, takimeve të studentëve që institucioni organizon. Nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. <i>(Evidencë 65)</i> Gjithashtu ZAK ofron informacion për bursa, konferenca studimore, informacion në lidhje me mobilitetet dhe progamet e shkëmbimeve jashtë vendit, si dhe praktikat profesionale zhvillohen në institucione shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 1)</i>		
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Konstatohet që, ZAK gjurmon studentët pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. Për periudhën 2018-2021 nga 220 studentë të diplomuar, 179 janë të punësuar. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 9)</i>		
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështet studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Konstatohet që, ZAK si dhe stafi akademik, mbështet studentët, nëpërmjet trajnimeve të organizuara si dhe nëpërmjet leksioneve të hapura, me figura të njohura të fushës së studimit, duke dhënë ndihmesën e nevojshme në përparimin shkencor të studentëve. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 9.11.12 & 4)</i>		
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Konstatohet që, stafi akademik, mbështet studentët, nëpërmjet organizimit të punës në laboratorët përkatës, sipas specifikës së hulumtimit, si dhe përdorimit të ambienteve praktike, të vëna në dispozicion të tyre. Gjithashtu, institucioni ofron një paketë rregullatore lidhur me mënyrën e hartimit dhe ndërtimit të diplomës. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 10)</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Konstatohet që, UniBa, ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit, në nivel institucional, <i>(Evidencë 3)</i> , në të cilën parashikohen drejtimet kryesore, lidhur me aktivitetet dhe mobilitetin e studentëve dhe të personelit akademik. <i>Por, Institucioni, nuk ka paraqitur një evidencë të qartë lidhur me numrin e studentëve apo të personelit akademik, të përfshirë në programin Erasmus dhe Erasmus +, lidhur me mobilitet.</i> <i>Rekomandojmë një strategji nxitëse, nga ana e institucionit, për të motivuar lëvizjen studentore dhe të personelit akademik.</i>

<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Konstatuam që, përfundimi i ciklit të dytë të studimeve master i shkencave, u mundëson studentëve, vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë. Studentët, zhvillojnë dy lëndë që i ndihmojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre në kërkimin shkencor, (Metodat sasiore të kërkimit dhe Metodatat cilësore të kërkimit). <i>(Evidencë 14)</i>. Gjithashtu, detyra e kursit, e cila dorëzohet për çdo lëndë (<i>përmban 20 % të vlerësimit</i>), përmban të gjithë elementët e një kërkimi shkencor, çka bën që studentët të kryejnë një mini-kërkim.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Konstatuam që, Institucioni, i ka të përcaktuara qartë politikat e përfshirjes së studiuesve të rinj, në projektet kërkimore, si dhe shtyllat kryesore të kërkimit shkencor dhe inovativ. <i>(Evidencë 3)</i> <i>Por, Institucioni, nuk ka paraqitur një evidencë të qartë lidhur me numrin e studentëve apo të personelit akademik, të përfshirë në projekte kërkimore vendës apo të huaj.</i> <i>Rekomandojmë një strategji nxitëse, nga ana e institucionit, për të motivuar përfshirjen e studiuesve të rinj, në projekte kërkimore vendës apo të huaj.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>Konstatuam që, UniBa, ofron mundësi, bazuar në hartimin e politikave me objektiv kryesor integrimin dhe inkurajimin e bashkëpunimit të personelit akademik aktual, si dhe të studiuesve të rinj. <i>(Evidencë 2 & 3)</i> <i>Por, Institucioni, nuk ka paraqitur një evidencë të qartë lidhur me numrin dhe/ose të dhëna, lidhur me bashkëpunimin dhe integrimin të kërkuesve shkencorë të huaj, për programin e studimit.</i> <i>Rekomandojmë një strategji nxitëse, nga ana e institucionit, për të motivuar përfshirjen e studiuesve të huaj, në projekte kërkimore vendës apo të huaj, për programin e studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Rezulton se, në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe rritjes së mobilitetit të studentëve, UniBa, ndjek politika favorizuese për këta studentë, duke lehtësuar procedurat e procesit të shkëmbimit të studentëve. <i>(Evidencë Takimi me studentët e programit të studimit)</i> <i>Por, Institucioni, nuk ka paraqitur një evidencë të qartë lidhur me numrin dhe/ose të dhëna, lidhur me mobilitetin dhe angazhimin e studentëve, në veprimtari ndërkombëtare.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>Rezulton se, UniBa, si dhe njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, harton politika dhe strategji lidhur me ndërkombëtarizimin e programit të studimit, për të rritur profilin e tij ndërkombëtar. <i>(Evidencë 3 & 4)</i> <i>Por, Institucioni, nuk ka paraqitur një evidencë të qartë lidhur me numrin dhe/ose të dhëna, lidhur me mobilitetin dhe angazhimin e studentëve dhe personelit akademik të huaj, në veprimtari kërkimore ose gjatë procesit të mesimdhënie.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

standardit		X	
Standardi V.8			
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Konstatohet se, institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës si dhe Koordinatorit i Departamentit. <i>(Evidence 12)</i> Gjithashtu, jashtë çdo departamenti ekziston këndi i informimit dhe njoftimeve që departamenti përkatës afishon. Zyra e Karrierës dhe Alumnit angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve master. Zyra e Dekanit të Studentëve u vë në dispozicion atyre, materiale dhe broshura informuese dhe orientuese si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për programin e studimit që do ndjekin. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni që përmban Manuali i Studentit.		
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Konstatohet që, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UniBa dhe Sekretarisë Mësimore, studentët kanë mundësi të informohen për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim etj. Gjithashtu, informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, realizohet nëpërmjet Portali Studentor. <i>(Evidencë 48.b1)</i>		
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Konstatohet se, nëpërmjet Zyra e Rekrutimit, Pranimit dhe Regjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve, Zyra e Alumni dhe Karrierës, <i>(Evidence 12)</i> , kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin informacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studentëve që institucioni organizon. Nëpërmjet “Manualit të Studentëve”, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës. <i>(Evidencë 65)</i> Praktikat profesionale zhvillohen në institucione shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit. <i>(Evidencë 34)</i>		
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato	Konstatohet që, ZAK, gjurmon studentët pas diplomimit duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe studentëve aktual të institucionit. <i>(Evidencë Dok. Shtesë 9)</i>		

në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se , institucioni ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. (Evidencë 8) Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UniBa bazohet në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe në Standardet Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë. Sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë ngritur me Vendim të Senatit Akademik të UniBa. UniBa, ka një organizim strukturor të brendshëm në lidhje me sigurimin e cilësisë, si dhe ka përcaktuar modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe ndjekja periodike e vlerësimit të veprimtarive të kryera akademike dhe shkencore, në përmbushje të standardeve të kërkuara. Ky sistem, përbëhet nga Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. (Evidencë 2 & 5) Gjithashtu, në nivel institucional funksionon Komisioni për Vlerësimin e Performancës. (Evidencë 11.a)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të	Konstatohet që , institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë, (Evidencë 2 & 5) , dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. (Evidencë 3)

jashtëm.				
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Konstatohet që, institucioni ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë, <i>(Evidencë 2 & 5)</i> , dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku janë të përfshirë jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm. <i>(Evidencë 3)</i>			
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit	Rezulton se, institucioni ka hartuar politika dhe procedura të qarta dhe periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Disa nga këto procedura periodike janë: <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësor i stafit akademik për matjen e cilësisë të procesit mësimor, <i>(Evidencë 41)</i> - Pyetësor për studentët për matjen e cilësisë të procesit mësimor, <i>(Evidencë 40)</i> - Raporteve analitike të vlerësimit të brendshëm që institucioni harton, <i>(Evidencë 35)</i> - Raport i vetëvlerësimit të programit të studimit, <i>(Evidencë B)</i> - Analiza vjetore e punës kërkimore shkencore nga ana e institucionit, në rang departamenti, <i>(Evidencë 43)</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjve të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.	Konstatohet se, vlerësimet e realizuara për elementë të caktuar të programeve të studimit në mënyrë periodike, çdo vit akademik, pasqyrohen në raportin vjetor të njësisë bazë, <i>(Evidencë 35)</i> si dhe në Raportin e Vetëvlerësimit të programit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”. <i>(Evidencë B)</i>
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit	Rezulton se, institucioni përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve nëpërmjet hartimit periodik të raportit të vlerësimit të brendshëm, i cili pëfshin analizën e objektivave të programeve të studimit që UniBa ofron, metodat e mësimdhënies, organizimin dhe administrimin e tyre si dhe format e vlerësimit. <i>(Evidencë</i>

të studimit të ciklit të dytë.	13 & 38)		
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në rang Insitucional (Evidencë B) dhe Raportit të Vlerësimit në rang Departamenti (Evidencë 35), rezulton se , institucioni përdor instrumente matës dhe metodologji vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.		
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Nëpërmjet instrumenteve matës për vlerësimin e pyetësoreve për matjen e cilësisë së procesit mësimor, rezulton se , (Evidencë 37a), studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogut përgjegjës. Pas analizës e të dhënave përkatëse të dërguar nga institucioni rezulton se të dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. (Evidencë 37)		
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Nga shqyrtimi i Plani Strategjik i Departamentit, rezulton se , institucioni ka përfshirë analizën SWOT, gjatë së cilës trajtohen rezultatet e vlerësimit, rezultatet e pritshme, mangësive dhe pritshmëritë për përmirësimin në vijim të cilësisë. (Evidencë 4)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Nga shqyrtimi i RVB rezulton se , çdo vit akademik, në mënyrë periodike, hartohet Plani Strategjik i njësisë bazë (Evidencë 4), në të cilin pasqyrohen porpozimet për ndryshimet plan programeve dhe elementëve të tjerë të programeve të studimit që DEFS ofron dhe ia përcjell për miratim Senatit Akademik. Të gjitha këto ndryshime pasqyrohen te Strategjia e Zhvillimit Institucional. (Evidencë 3) Konstatojmë, gjithashtu se DEFS kryen në mënyrë periodike Raportin e Vetëvlerësimit të Programit të Studimit. (Evidencë 38)
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të	Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme si: - Analiza e punës kërkimore shkencore në rang departamenti

<p>ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p><i>(Evidencë 38),</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategji e Sigurimit të Cilësisë, <i>(Evidencë 37)</i> - Plani strategjik i UniBa, <i>(Evidencë 3)</i> - Plani Strategjik i programit të studimit, <i>(Evidencë 4)</i> 			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Rezultoni se, institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga stafi akademik <i>(Evidencë 41)</i> - Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga studentët <i>(Evidencë 40)</i> - Raportin e Vetvlerësimit të Programit të Studimit Master Shkencor Mësuesi Edukim Fizik dhe Sporte. <i>(Evidencë 38)</i> 			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program</p>	<p>Intitucioni realizon në mënyrë periodike dy pyetësorë 1) me studentët dhe 2) me stafin akademik:</p> <p>1.Për vlerësimin mësimdhënies nga stafi akademik <i>(Evidencë 41)</i></p> <p>2.Për vlerësimin mësimdhënies online nga studentët <i>(Evidencë 40)</i></p> <p><i>Rekomandojmë që institucioni të zhvillojë sondazhe, fokus grupe ose/dhe intervista me alumnin, me personelin ndihmësakademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij program studim apo/dhe që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në



vijim të tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Rezulton që, nëpërmjet analizës SWOT të Planit Strategjik të departamentit (<i>Evidencë 4</i>), si dhe plani i vetëvlerësimit të programit të studimit “Master Shkencor” në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” (<i>Evidencë 38</i>), institucioni siguron përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.		
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rezulton se, institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave (<i>Evidencë B</i>).		
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Rezulton se, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti, siç pasqyrohet edhe në grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë si dhe në Rregulloren e Zyrës së Monitorimit. (<i>Evidencë 13</i>)		
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në Rregulloren e Mbarëvajtjes së Kurrikulave dhe Procesit Mësimor në UniBa, (<i>Evidencë 59</i>), rezulton se, institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve.		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Rezulton se, marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka me institucionet arsimore dhe jo vetëm për realizimin e praktikave profesionale luajnë rol aktiv në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. (<i>Evidencë Dok. Shtesë 1</i>)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rezulton se, institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë transparente dhe bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UniBa.			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konfirmojmë që, institucioni ka hartuar Rregulloren e UniBa (<i>Evidencë 5</i>), Rregulloren në rang njësie kryesore, (<i>Evidencë 6</i>) si dhe Planin Strategjik të Programit të Studimit, (<i>Evidencë 4</i>) duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Konstatojmë se, në Planin Strategjik të Programit të Studimit Master Shkencor në “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte” është hartuar analiza SWOT e shoqëruar me një plan masash që synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara nga ky program. (<i>Evidencë 4</i>)			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Konstatojmë se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë, mbështetur në Rregulloren e NJZHKC, miratur nga Senati Akademik në vitin 2021. (<i>Evidencë 8</i>)			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimi me NJZHKC, rezultoi se, institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t’i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotësojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" i Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti "BARLETI"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Konfirmojmë se Programi i studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" është hartuar në frymën dhe në përmbushje të plotë me kërkesat e ligjit;
2. Programi ofron një diplomë ambicioze, ku ndërthuren më shumë se dy disiplina, edukimi fizik / sportet dhe edukimi akademik. Si e tillë, kjo diplomë, reflekton ekuilibrin e mjaftueshëm ndërdisiplinar;
3. Programi Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte" i përgjigjet një kërkesë të identifikuar në tregun e punës. Ky program studimi sfidon problematikën e dikurshme absurde ku një student i qe përfundonte studimet MSc i mohohej e drejta për tu punësuar si mësues i edukimit fizik;
4. Programi operon mbi një repertor të gjerë disiplinash që thellojnë dijen rreth akademizmit dhe dijen rreth edukimit fizik dhe sporteve. Kampusi i ri me ambiente moderne pune e studimi, pajisur me të gjitha teknologjitë e reja krijon kushte e mundësi bashkëkohore për realizimin cilësor të këtij programi;
5. Format e vlerësimit të programit të studimit garantojnë cilësinë e tij për gjatë gjithë procesit mësimor dy-vjeçar. Instrumentet e vlerësimit janë mix dhe operojnë në rrafshin: vertikal, horizontal, periodikisht, rnbështetur në indikatorë të aksesueshëm dhe të besueshëm;
6. Staf i akademik i brendshëm mbulon me kompetencë programin dhe disponon titujt dhe gradat akademike në përmbushje të detyrimeve ligjore;
7. Programi ka qëndrueshmëri përmbajtësore dhe logjistike;

Pika të dobëta

1. Mungesa e një studimi të mirëfillët të tregut të punës i cili është shumë i nevojshëm për një ecuri edhe më të suksesshme të këtij programi studimi. Departamenti të bëjë studime të vërteta të kërkesave të tregut të punës e mos të mbetet në opinione individuale siç rezulton në evidencat e paraqitura;
2. Mungesa e marrëveshjeve dhe mobiliteteve me universitetet e huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme nuk shkon në një linjë me proceset e ndërkombëtarizimit të universiteteve shqiptare prandaj fillimi i këtij procesi do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike të këtij programi;

3. Në tabelat e punës shkencore referime, botime në vite nuk gjejmë të pasqyruar punën kërkimore shkencore vjetore (si detyrim akademik) të çdo stafi akademik me kohë të plotë pjesë e departamentit i cili mbulon këtë program studimi;
4. Kreditet ECTS të Detyrimeve Përmbyllëse-E nuk janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Këto detyrime duhet të variojnë nga 10-15%, por në fakt u është dhënë 25% apo 30 kredite të cilat janë barazuar me të gjithë semestrin e katërt i cili i është dedikuar vetëm punimit të tezës së diplomës. Shtrirja e punimit të diplomës gjatë të gjithë semestrit të katërt duhet rishikuar menjëherë.

Rekomandime

1. Ka nevojë për përmirësimin e kurrikulës apo planit mësimor sepse ka disa mospërputhje në përqindjet e kategorive të komponentëve mësimorë sidomos në semestrin e katërt ku detyrimet përmbyllëse arrijnë në 30 kredite apo 25% kur VKM-ja përkatëse lejon maksimumi 15%. Shtrirja e punimit të diplomës gjatë të gjithë semestrit të katërt duhet rishikuar;
2. Në evidenca nuk është paraqitur asnjë syllab i plotë në gjuhën angleze kur dihet prej disa vitesh që në programet e ciklit të dytë të studimit këto janë të nevojshme edhe sepse bordi i administrimit ka në përbërjen e tij edhe profesorë të huaj. Është kërkesë imediate që si fillim të gjitha syllabet e lëndëve/moduleve të përgatiten edhe në gjuhën angleze;
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sporteve duhet të bëjë më shumë në drejtim të nënshkrimit të marrëveshjeve me universitetet e huaja të cilat ofrojnë programe studimi të njëjta apo të ngjashme e cila do të mundësonte funksionimin e mobiliteteve për studentët dhe stafet akademike të këtij programi studimi;
4. Të rishikohet plani mësimor i këtij programi studimi sepse në strukturën e tij na paraqitet me lëndë por pa module që formësojnë lëndën dhe tek ngarkesa totale në orë në planin mësimor mungon pjesa laboratore si element shumë i rëndësishëm për formimin e kërkuesve të rinj shkencor;
5. Fakulteti dhe departamenti janë në kohën e duhur dhe kanë të gjitha kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore për ta organizuar konferencën e parë shkencore me pjesëmarrjen qoftë edhe në nivelin poster të studentëve të këtij programi studimi;
6. Institucioni të hartojë planin financiar të Programit të studimit Master Shkencor “Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte”, ku të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij;
7. Institucioni të zhvillojë sondazhe, fokus grupe ose/dhe intervista me alumnin, me personelin ndihmësakademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në

realizimin e këtij program studim apo/dhe që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.

Conclusions of the evaluation of the study program of the second cycle Master of Science "Teacher in Physical Education and Sports" of the Institution "BARLETTI" University

Strengths and affirmations

1. We confirm that the Master of Science study program in "Teacher in Physical Education and Sports" is designed in the spirit and in full compliance with the requirements of the law;
2. The program offers an ambitious degree, combining more than two disciplines, physical education / sports and academic education. As such, this degree reflects sufficient interdisciplinary balance;
3. The program Master of Science in "Teacher in Physical Education and Sports" responds to an identified demand in the labor market. This study program challenges the once absurd problematic where a student who completed MSc studies was denied the right to be employed as a physical education teacher;
4. The program operates on a wide range of disciplines that deepen knowledge about academia and knowledge about physical education and sports. The new campus with modern working and study facilities, equipped with all new technologies creates contemporary conditions and opportunities for the quality realization of this program;
5. The evaluation forms of the study program guarantee its quality throughout the two-year teaching process. Evaluation instruments are mixed and operate in the plane: vertical, horizontal, periodic, based on accessible and reliable indicators;
6. Internal academic staff competently covers the program and has academic titles and degrees in fulfillment of legal obligations;
7. The program has substantive and logistical consistency.

Weaknesses

1. Lack of a proper labor market study which is very necessary for an even more successful performance of this study program. The Department have to make real studies of labor market demands and not to remain in individual opinions as it results in the presented evidence;
2. The lack of agreements and mobility with foreign universities which offer the same or similar study programs does not go in line with the processes of internationalization of

Albanian universities, therefore the beginning of this process would enable the functioning of mobility for students and academic staff this program;

3. In the tables of scientific work references, publications in years we do not find reflected the annual scientific research work (as an academic obligation) of each full-time academic staff part of the department which covers this study program;
4. Closing Obligations E credits, are not in accordance with the percentage provided by the legislation in force. These obligations should vary from 10-15%, but in fact they have been given 25% or 30 ECTS which are equal to the entire fourth semester which is dedicated only to the work of the diploma thesis. The scope of the diploma thesis throughout the fourth semester should be reviewed immediately.

Recommendations

1. There is a need to improve the curriculum or syllabus because there are some discrepancies in the percentages of the categories of teaching components, especially in the fourth semester where the closing obligations reach 30 credits or 25% when the relevant DCM allows a maximum of 15%. The scope of the diploma thesis throughout the fourth semester should be reviewed;
2. No complete syllabus has been presented in the English language when it is known for several years that in the programs of the second cycle of study these are necessary also because the board of administration has in its composition also foreign professors. It is an immediate request that as a start all syllabi of courses / modules be prepared in English;
3. The Faculty of Social Sciences, Tourism and Sports should do more in terms of signing agreements with foreign universities which offer the same or similar study programs which would enable the functioning of mobility for students and academic staff of this study programs;
4. To review the curriculum of this study program because in its structure it is presented with subjects but without modules that shape the subject and the total workload per hour in the curriculum lacks the laboratory part as a very important element for the formation of new researchers;
5. The faculty and the department are on time and have all the human and infrastructural capacities to organize the first scientific conference with the participation even at the poster level of the students of this study program;
6. The institution to draft the financial plan of the Master Scientific Study Program "Teacher in Physical Education and Sports", which contains the funding of human resources in service of the implementation of the program, operating costs for the maintenance of facilities and technologies supporting the learning process, costs for the

library and the enrichment of literature and access to online libraries, financial obligations, domestic or foreign grants received and service contracts concluded in order to carry out the study program and other items, according to its specific nature;

7. The institution to conduct surveys, focus groups and / or interviews with alumni, academic support staff and other collaborators who contribute to the implementation of this study program and / or who serve to assess the knowledge and competencies acquired by this program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X